

Hisham Muhamed Tilbete

Për hulumtuesit e fesë së vërtetë

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Autor:

Hisham Muhamed Tilbete

Titulli:

Për hulumtuesit e fesë së vërtetë

Përktheu:

Dr. Musli Vërbani

Korrektoi:

Burim Bunjaku

Botues:

Përkthyesi

Kaçanik, 2021

Përmbajtja:

Hyrje 6

KAPITULLI I PARË 8

PËR KRISHTERËT 9

KAPITULLI I DYTË 12

PSE E PRANOJMË ISLAMIN 13

KAPITULLI I TRETË 16

KAPITULLI I KATËRT 22

a. Në çështje të Astronomisë 23

b. Gjeologjia 27

c. Në shkencën detare 32

d. Embrionologjia 35

KAPITULLI I PESTË 38

KAPITULLI I GJASHTË 42

Fusnotat: 44

Hyrje

Çështja e besimit është çështja më e rëndësishme e jetës së njeriut. Nuk besoj se e teproj nëse them se është më e rëndësishme se çështja kombëtare, apo largimi i padrejtësive shoqërore edhe pse në mes tyre nuk ka kundërshtime. Me fjalë tjera është më e rëndësishme se pasuria, reputacioni, pozita, apo angazhimi në dituri, art, pasuri, punë apo kompozimin, profesion, etj., etj.

Ka njerëz të cilët shikojnë pasurinë e prindit, apo jetën e tij e angazhohen në pasuri, edhe pse pasuria ndonjë ditë do ta nënçmon, ose shikon në ndonjë grua të cilën e do ose shikon të kënaqet me të mirat e kësaj bote, në veshje, ushqim, automjete, mirëpo që të gjitha mjetet e kësaj bote janë kalimtare. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: **“Ju njerëz dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është shembull i një shiu prej të cilit bima habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej të thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga All-llahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues.”** (Hadidë : 20)

Pas kënaqësive të kësaj bote do ta shijojmë vdekjen, që ta shohim realitetin e vetes sonë, atëherë me syrin e së vërtetës në radhë ideologjitë dhe besimet të cilat tregojnë përgjithshmërinë. Për këtë arsye duhet ta shfrytëzojmë shansin e jetës dhe të hulumtojmë për besimin e vërtetë, duke sakrifikuar mund, kohë dhe pasuri.

Edhe pse ka prej disa feve që ne i pëlqejmë, ne nuk mund të jemi të kënaqur dhe nuk pajtohemi në disa aspekte dhe çështje të

tyre. Të pyesim dhe të lexojmë për ato çështje se mos ndoshta faji është në veten tonë.

Po ashtu ne e kemi për detyrë që ta prekim perden e dyshimit dhe traditën e të parëve dhe të mos pasojmë fenë e të parëve tanë, vetëm se është feja e të parëve tanë: **“Dhe kur u thuhet atyre, pasoni atë çka ka zbritur All-llahu, thonë: gjithsesi ne do të pasojmë atë çka na kanë lënë neve prindërit tanë, edhe pse prindërit e tyre nuk kanë logjikuar aspak dhe nuk kanë qenë të udhëzuar.” (Suretul Bekare).**

Njeriu, thjesht nuk posedon atë që t'i ikë vendimit për të marrë vendim për “Imanin”.

Duhet ta pyesim veten tonë:

A është të pasohet Krishterizmi?

A është e mundur të pranohet Islami?

Përgjigja në këto dy pyetje, gjendet në vazhdim dhe në këtë punim.

KAPITULLI I PARË

PËR KRISHTERËT

Parimi kryesor i krishterizmit të cilin kurrsesi nuk e pranon logjika, besimi në shpirtëzimin e Zotit, në Trini¹, është parim i gabueshëm i cili thotë që njeriu e bartë mëkatën që nga njeriu i parë (Ademi) dhe këtë duhet ta shpaguejnë (bijtë) pasardhësit e tij me anë të paradoksit ku sipas tyre Zoti duhet të zbresë në tokë si në formën e njeriut dhe të kryqëzohet² në mënyrë që të i fshijë gabimet e njerëzve.

Pa marrë parasysh këtë parim, krishterizmi nuk është ajo fe e cila personalisht ka thirrur për këtë. Në vetë dëshminë e Inxhilit, Mesihu (Krishti sipas mendimit krishterë), kurrë në asnjë Inxhilë nuk ka thënë se Zoti do të shpirtëzohet, apo se Ai është djalë i Zotit, apo ai së bashku me të Atin dhe Shpirtin e shenjtë janë “Treshi i shenjtë”³.

Vërejtje: Ka ekzistuar “Treshi i hershëm” në disa sekte krishtere në fillim të shekullit të dytë – i cili pretendonte se Zoti është i përbërë prej Atit, të Ëmës dhe Birit. *Shiko: “The Nag hammady library” nga James M. Robinson.*

Ndërsa vet Mesihu thotë ndryshe: **“Unë asgjë nuk mund të veproj me dëshirën time, por gjykoj ashtu siç e dëgjoj. Gjykimi im është i drejtë pse unë nuk angazhohem që t’i realizoj dëshirat e mia, por që t’i realizoj dëshirat e Atij i cili më ka dërguar.”** (Johan : 30).

“Unë do të ngrihem te Ati im dhe Ati juaj, te Zoti im dhe te Zoti juaj.” (Johan 20:17).

Është interesante se Kur’ani e thërret besimin e krishterë në këto ide të cilat gjinden në vet librat e tyre.

“Nuk më takon mua të them atë që s’është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, Ti do ta dije. Ti e di ç’ka në mua, e unë nuk e di ç’ka në Ty. Ti je më i dijsmi i të fshehtave!

Unë nuk u kam thënë tjetër atyre pos asaj që Ti më urdhërove: Ta adhuron All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta, kam qenë përcjellës i tyre e pasi që më

more mua, Ti ishe Përcjellës (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitarë për çdo send.”⁴ (Maide: 116-117).

Kur’ani po ashtu thërret (bënë ftesë) në atë që Mesihu është vetëm njeri duke e cekur tekstin e Inxhilit, në një vend tjetër: **“E kanë mohuar të vërtetën (kanë bërë kufër) ata që thanë: “All-llah është ai, Mesihu, bir i Merjemës”. E vetë Mesihu (Isai) tha: “O beni Israil, adhuroni vetëm All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhenetin dhe vendi i tij është Zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.” (Maide : 72)**

Pas të gjitha këtyre teksteve të cilat i cekëm më lartë në lidhje me Mesihun se ai ka qenë thjesht njeri dhe ashtu është përmendur në Inxhil, vijmë në konkluzion (përfundojmë) se Krishterizmi nuk është ai për të cilën ka ardhur Mesihu.

Në këtë kanë besuar disa “Ebijonijin” (në shek. I Isa a.s.) dhe “Ariosinis” (Paulicians) të gjitha këto kanë qenë sekte krishtere të cilat kanë besuar se Isa ka qenë vetëm Pejgamber.

Krishterizmi i sotëm është vetëm si rezultat i të shenjtit Paul. Këtë e gjejmë në letrat e para dërguar Romës (në Inxhil) i cili me shenjtërinë e tij tregon fuqimisht se Isa është djali i Zotit pasi që ai nuk ka mbetur me të vdekurit.

Pra, Mesihu pasi që nuk është me të vdekurit sipas pretendimit të tyre është “argument” se është djalë i Zotit. Në qoftë se është ashtu, atëherë si qëndron puna me ata të cilët i ka ngjallë Isa pasi që kanë vdekur!? Si qëndron puna me pejgamberët e tjerë si Illija, Joshua!? A thua a janë edhe ata djemtë e Zotit!

Pauli ka konkluduar se Isa është djalë i Zotit ndërsa parimet krishtere nuk janë ato parime për të cilat ka ftuar Mesihu. Por ato janë “përmbledhje” të cilat i kanë zgjedhur udhëheqësit e themelimit të kësaj feje⁵. Për atë, nuk është çudi kur në psalmet krishtere lexojmë temat “Besimet para krishtere”, “Zhvillimi i fesë krishtere”. Besimi krishter i sotëm ka marrë vendim në Kongreset Meskunije të mëdha. Kongresi më i njohur, Kongresi i “Nikijës” (325 sipas isa a.s.), në të cilin fituan në “vota me

shumicë” përkrahësit e Palit me forcën e mbretit Kajser të Konstantinopolisit (Dairetul Mearif el Britanije), kapitulli “Ecumenial Counsils”. Pra, Pali ka konkluduar se Mesihu është Zot, sepse sipas pretendimit të tij nuk ka vdekur (është ringjallur)!! Këtë konkludim e kanë shfrytëzuar themeluesit e fesë krishtere në çështje tjetër. Është e ditur se besimi në “Trinitet” nuk është besim i “Ortodoksëve”. Pra “Triniteti” si besim është i pranuar në shekullin e IV (shek. e IV e më vonë, ndërsa më herët jo), (shiko temën “Trinity”, shtypshkronja e shkencave britanike). Pastaj është mbajtur kongresi i Meskonit në vitin 381 sipas Isa a.s. në Konstantinopolis për t’i dhënë fund kundërshtimeve në mes të atyre që kanë besuar në *Zotin shpirti i shenjtë*, dhe në mes të atyre që kanë besuar në të (monoteistët). Kongresi mori vendim për të pranuar besimin në shpirtin e shenjtë. Por, pse? Sepse shpirti i shenjtë nuk është gjë tjetër pos shpirt i All-llahut. Nëse themi se shpirti i shenjtë është i krijuar atëherë del si rezultat se edhe All-llahu është i krijuar. Pra ky është rezultat i prodhimit njerëzor.

Për këtë arsye nuk e pranoj krishterizmin sepse nuk është fe e logjikës dhe nuk është shpallur prej All-llahut te i dërguari i Tij, por është prodhim njerëzor.

KAPITULLI I DYTË

PSE E PRANOJMË ISLAMIN

- Ne e pranojmë këtë besim të logjikshëm dhe të natyrshëm.
- All-llahu është Një, me të gjitha cilësitë e Tij dhe nuk i ngjason asgjë Atij.
- Një i vetëm dhe nuk është i ndarë.
- I vetëm në veprimtarinë e Tij dhe nuk ka as shok as rival. Nuk ka lindur, dhe nuk është i lindur dhe asgjë nuk i ngjason dhe nuk është i barabartë me të.

a.

E pranojmë islamin për shkak të librit të shenjtë (Kur'anit). Libri i vetëm i cili nuk ka pësuar asnjë ndryshim gjatë 14 shekujve. I cili i ka zbritur Muhamedit a.s. dhe vetëm ai ka qenë përgjegjës për të. Kur'ani ndryshon nga Inxhili sepse Inxhili ka pasur nevojë që të kundërshtohet dhe të kritikohet në vetë tekstet për të ardhur deri te teksti më i përshtatshëm me origjinalin e humbur (Dairetul Mearif el Britanie, Kapitulli "Bibla")⁶.

b.

Libri (Kur'ani) në të cilin kurrë nuk lexojmë se All-llahu ka pushuar (Inxhil, 2:2)⁷ ose ka fjetur (Mezamirë, 87:56) ose ka dalë në dyluftim me njeriun dhe ka ngadhënjyer njeriu ndaj Tij (Tethnije, 32 : 22.32).

Por ne në Kur'an lexojmë: **"All-llahu është Një, nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotje as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë**

vetëm aq sa ka dëshiruar. Kursija e Tij (dija – sundimi) përfshin qiejt dhe tokën, kujdesi i tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi.” (Bekare : 255)

c.

Libri (Kur’ani fisnik) në të cilin nuk lexojmë se peygamberi “Luti” ka bërë marrëdhënie seksuale me të bijën e tij (Tekvij, 9:3-37) ose peygamberi tjetër “Rubini” ka bërë marrëdhënie seksuale me gruan e prindit të tij (Tekvij, 23-12) ose “Nuhi” ka qenë i dehur dhe është zhveshur para bijave të tij (Tekvij, 9:21) ose peygamberi “Davud” ka fjetur me gruan e shokut të tij i cili ka vdekur pasi që e ka dërguar që të luftoj deri sa ka vdekur (Samvili i dytë, 11:1-15).

Ne nuk lexojmë në Kur’an se peygamberi Jakub e ka vjedhur “taxhin” e vëllait të tij (Tekvij, 37:18-29) ose peygamberi Harun është ai i cili e ka ndërtuar viçin prej arit që populli i tij ta adhurojnë si Zot në vend të All-llahut (Huruxh : 32). Mirëpo ne në Kur’an lexojmë **“E Haruni atyre u pat thënë më parë: O populli im, ju vetëm u sprovuat me të, pse Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi, andaj ejani pas meje dhe më dëgjoni për këtë që po ua them.”** (Ta ha : 9)

Ne pajtohemi me Kur’anin në të cilin nuk lexojmë në të se peygamberi Sulejman i ka pasur 700 gra dhe 300 shërbëtorë⁸ dhe se zemra e tij është larguar nga All-llahu dhe ka adhuruar zotat e popujve të hershëm para se të vdiste (Muluk 11:1-9). Mirëpo në Kur’an lexojmë: **“E dëgjuan dhe e pasuan atë që e thoshin djajtë në kohën e Sulejmanit. Sulejmani nuk ishte jobsimtar por djajtë ishin ata të cilët nuk kishin besuar.”** (Bekare : 102)

Ne pajtohemi me librin (Kur’anin) në të cilin nuk lexojmë se peygamberi (Joshua) kur e ka çliruar një qytet i ka shkatërruar të gjithë banorët duke i gjykuar me vdekje të gjithë banorët, me burra, me gra, me fëmijë, me pleq, derisa edhe kafshët si lopët, dhentë, dhe gomarët (Tevratë Joshua, 6:21), pastaj Tivrati nuk

komenton atë ngjarje të banorëve të peygamberit por e përkujton në një vend tjetër (Aded, 31:13-18) ku thotë se Musa ka urdhëruar për vrasjen e fëmijëve meshkuj e femra të reja të cilët ishin rob. Sipas tyre këtë Musa e ka urdhëruar për popujt të cilët ishin nisur për të shkuar në tokën e premtuar, ndërsa për vet banorët e tokës së premtuar urdhri ishte edhe më i rreptë dhe më i egër ashtu qysh e tregon Tevrati në këshillat e Musait – *All-llahu e ruajttë Musaun për të këshilluar një gjë të tillë* - **“Ndërsa vendet e popujve të cilat ka urdhëruar Zoti i juaj për të qenë məkëmbës dhe trashëgimtarë të tij mos lejoni asnjë banorë të gjallë por shkatërroni çdo gjë që ka në të edhe vajzën në prehër të Atit”** (Tevratë : Tethnie 2:16-17).

Mirëpo në Kur’an lexojmë : **“(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë e falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.”** (Haxh : 41).

E lexojmë edhe hadithin ku Muhamedi a.s. i këshillon (urdhëron) shokët e tij **“Mos shkatërroni, mos teproni, mos masakroni, mos vritni fëmijët, dhe as ata që janë në faltore.”** (transmeton Ahmed i nga ibn Abasi).

Po ashtu lexojmë hadithin ku Muhamedi a.s. këshillon **“Mos vritni plakun e lodhur dhe as fëmijën e vogël dhe as gruan, mos plaçkitni, por tuboni pasurinë në një vend, tregohuni edukativ se jeni rregullues, dhe bëhuni të mirë se All-llahu i do të mirët”** (transmeton Ebu Davudi nga Enesi)⁹.

Patjetër duhet t’i parashtrojmë pyetje vetes: Pse në Kur’an nuk i hasim këto çështje të përmendura të cilat janë të palogjikshme, por hasim përgjigjen: **“A nuk po mendojnë dhe nuk po analizojnë Kur’anin. Po t’ishte Kur’ani prej dikujt tjetër pos All-llahut do të hasnin në të kundërshtime të shumta.”** (Nisa : 82)

KAPITULLI I TRETË

Ne e pranojmë islamin për shkak të specifikave tjera, të cilat janë shumë interesante dhe të rëndësishme në Kur'an, e ato janë faktet kur'anore të cilat kanë qenë në fletushkat e mëhershme.

Me këtë, kam për qëllim vendet e pajtueshmërisë në mes të Kur'anit dhe librave të mëhershme. Si f.v. një pjesë e një ngjarjeje në terminologji apo një shembull. Rrallë se mund të gjesh ndonjë libër prej librave jehud, apo të krishterë të cilat kanë qenë para Kur'anit e që nuk kanë të përbashkëta me Kur'anin, pa marrë parasysh ai libër a është libër juridik, apo jojuridik, a është në dhjatën e vjetër apo në dhjatën e re, në fletët e Telmudit, të Minshas, apo Terxhumit, në Midrash apo në apokrifë (librat sekrete) apo në libra historik (Josabiros Kajserit, Filo Iskenderit-Josipit) apo në librat e papëve të kishave të para.

Në masë më të vogël shohim dëshmi të Kur'anit në librat e Sabiinëve (Kanzania), të Hindusëve (El-Fijda), të Babilonëve, dhe të Egjiptasëve të vjetër (Libri i të vdekurve).

Edhe pse në librat e shenjta ka dëshmi të popujve të vjetër, mirëpo ato janë dëshmi të palogjikshme, si besimi i trinitetit, dhe besimi se i biri i Zotit është Zot, djalë i virgjërshës i cili është sakrifikuar në kryq për t'i pastruar mëkatet e njerëzimit, e cila është ngjarje e ngjashme e përmendur te Hindusët dhe te Budistët, e disa prej tyre përmenden në fetë e Egjiptasëve të vjetër¹⁰. Po ashtu mund të haset një ngjashmëri interesante në mes të besimeve dhe adhurimeve të popujve të vjetër të Azisë së mesme të cilat kanë qenë sekrete me fenë krishtere. Zotat e këtyre feve vdesin në një sezon të caktuar, e pastaj më vonë ringjallen, ato janë Zota që i ngjasojnë njeriut. Si p.sh. Bariu i quajtur Atis dhe Edvenisi, për të cilin thuhet se është djalë (fryt) i kontaktit seksual të paligjshëm në mes të vëllait dhe të motrës. Që do të thotë se ata nuk kanë qenë asgjë tjetër përpos njerëz të zotave të tyre, me dëshirën e zotave të të tjerëve. Simbolikisht këto fe kalojnë duke pasuar njëra-tjetrën në epoka të ndryshme, me të cilat praktikisht në ato epoka ka kaluar zoti i tyre. Dhe, me këtë unisim me zotin, i cili e ka ndryshuar qenien e tij të veçantë, i bashkohet njeriut që njeriu pastaj të kalojë të njëjtën rrugë dhe të bëhet vet zot. Kjo na kujton atë që në krishterizëm quhet

“Shenjtërimi (të bërit e Mesihut Zot), (Historia kishtare : Xhon Larmir)”.

Unisimi ka qenë qëllimi kryesor të të gjitha këto rituale siç është me ritualin e dhënies së gjakut dhe vetëflijimi. Nga vetëflijimi dhe sofra e ushqimit në të cilin njerëzit hanin mish, njerëzit e konsideronin Zot, e pastaj llogaritnin, se me atë ushqim ato janë bashkuar në Zotin (janë shpirtëzuar në Zotin). A nuk është kjo e ngjashme me ritualin që të krishterët e quajnë darka e Zotit (Kjo gjendet në librin “Krishterizmi, zanafilla dhe zhvillimi i saj” autor Çarl Xhinbiri fq.92-99)”.

Sa i përket besimit, ngjashmëria më e madhe e të krishterëve është besimi i ngjashëm me filozofinë e Grekëve të vjetër. Në këtë kontekst na mjafton të përmendim thënien e “Lahutës së vjetër” të Kliment Iskenderi (Ka jetuar në vitin e dytë sipas Isa a.s.). Nëse krishterizmi dëshiron të përhapet në botën Greke, ajo duhet të zhvishet nga rroba Semite dhe të vishet me rrobën greke (“Historia Krishtere”, Volumi II fq. 50 Xhon Larmir).

Këto krahasime kur’anore vazhdimisht i shohim në ato libra, edhe librat e tilla janë të shumta, sikurse dihet një libër ka më shumë se një herë tekstin e njëjtë.

Tevrati përbëhet prej gjashtë teksteve parësore (EL-BESHITA, EL-KULIXHATA, ES-SEBIJNIJETI, ES-SAMIRIJETI, ET-TERXHUM dhe EL-KIJASIJETI).

Libri “Kijasij” përbëhet prej tre teksteve sekondare (El-Iluhij, El-Juhij dhe El-Kehnuti). Këto tekste janë bazë përpos teksteve sekondare. Dhe çdo botues i librit të shenjtë patjetër duhet të përdorë më shumë se një tekst prej këtyre teksteve, duke u mbështetur në bazën që e quajnë “shkenca e kritikës së teksteve” për të arritur te teksti më i afërt i cili tekst është më i përafërti me tekstin e humbur (“Hyrje në Dhjatën e vjetër”, botues “Darul Mashrik” viti 1989).

Ne shohim gjithmonë argumente të Kur’anit edhe pse këto libra të sipërpërmendura janë shkruar në gjuhë të ndryshme si në gjuhën latine, arabe, samirije, greke, aremije, sirjaniye, kaptije, habeshije, mindaije e në shumë e shumë gjuhë të tjera.

Edhe pse këto libra nuk i kemi gjetur vetëm një herë, por që janë tubuar duke kaluar me shekuj, duke filluar nga shekulli i katërt e deri më sot shumicën e këtyre librave i kemi gjetur se janë botuar pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s. Të fundit e kemi gjetur “shkrimet e Bahrul Mejti” (1947-1956).

Vazhdimisht hasim argumente të Kur’anit në librat e mëhershëm, edhe pse ato libra nuk janë të një vendit, por të vendeve të ndryshme: HAMADI VEL KAHIRA (XHENEZA), KUHUF BHRUL MEJTI, EL HABESHIJE, EL VATIKAN dhe libraritë “NUBEBELA” të Evropës.

Edhe pse këto libra kanë qenë shumë të rralla në kohën e pejgamberit s.a.v.s. dhe se nuk kanë qenë botime të shtypshkronjave por kanë qenë dorëshkrime, sepse nuk kanë ekzistuar shtypshkronjat, po ashtu kanë qenë të shqyera fletët e feve të shtypura, posaçërisht ato krishtere.

Vazhdimisht i shohim këto argumente, edhe pse volumi i këtyre librave ka qenë i madh (i shumtë), mirëpo kanë qenë të fortifikuara dhe ka qenë shumë vështirë të arrihet deri te ato, pasi janë mbajtur sekret.

Vazhdimisht i shohim këto argumente të argumentuara logjikisht edhe pse ato libra kanë pasur plot e përplot sqarime të palogjikshme.

Do të sjelli shembull për këtë specifikë argumentimet e Kur’anit në librat e mëhershme.

Dihet se tregimi i Jusufit a.s. është tregimi i vetëm i cili në Kur’an është i përmbledhur vetëm në një vend (sure). Këtë tregim nuk mund ta hasësh siç është në Kur’an në asnjë libër të librave jehude apo krishtere.

Në tevratin (Kijasijeti Sebijnijeti) të cilin sot e kemi në dorë, mund të gjejmë një pjesë të tregimit. Edhe pse me të gjitha sqarimet e transmetimeve të Tevratit, prapë se prapë në Kur’an nuk e hasim siç është pjesa e tregimit të tevratit, ashtu që tregohet tregimi i Jusufit pa kurrfarë ndërlidhje, pra na tregohet neve krejt tregim tjetër. E tregimi tjetër është se Jehuda, i cili është prej fëmijëve të Jaëkubit ka fjetur me gruan e vëllait të tij.

Sa i përket pjesës së dytë të tregimit të Jusufit në Kur'an, mund të gjendet në një numër të madh të librave të pasuesve të librit (Ehlil Kitab) përpos tevratit. Këtë pjesë, pra pjesën e dytë, e shohim plotësisht dallues dhe që ndryshojnë në mes vete në librat e pasuesve të librit. Në një pjesë të tregimit të Jusufit a.s. tregohet për ëndrrën e Jusufit a.s. se si e ka parë babanë e tij. Në rend të parë e gjejmë në librin "Adijat el Jehudije" (të Historianit Jusufus). Në një pjesë të tregimit të Jusufit a.s. "O baba ynë, dërgoje me ne nesër me qëllim që të luaj e të zbavitet." e gjejmë në librin "Biskitarijati" dhe "Sufur aded". Këto dy libra përputhen me Kur'anin sa i përket kësaj pjese por janë në kundërshtim me vet Tevratin. Pjesën "Dhe e frymëzuam që për çështjen e tyre t'i informojë ata" e gjejmë në një libër tjetër. Pjesën "dhe e shitën me çmim shumë të lirë." e gjejmë në një libër tjetër, pjesën "Dhe erdhën në mbrëmje te babai i tyre duke qarë." në librin "Uhudul Esbat" i cili është prej librave sekrete. Po ashtu pjesën "E ngrëni ujku." në librin "Jashar we ya sheb".

Kështu pra siç i përmendëm, kësisoj i gjejmë të ngjashme njëzet e gjashtë pjesë në më shumë se tridhjetë libra.

Te të gjitha librat e ehlul kitabit të cilat i përmendëm hasim detaje dhe shpjegime të palogjikshme të cilat detaje nuk i gjejmë në Kur'anin fisnik, si f.v. libri "Tenhuma" përmend se kur Jusufi ia ndalë Benjaminin Jehudës fillon një përlëshje e madhe në mes tyre sa që edhe melaqet zbresin që të shohin përlëshjen ndërmjet "Bikut" (bizonit) Jusuf dhe Jehudës "Luan". Libri "B.R" dhe Telmudi shtojnë edhe atë se punëtorët më të fuqishëm të Jusufit i kanë humbur dhëmbët e tyre prej britmës së madhe të Jehudës. Në një vend tjetër këta dy libra përmendin se melaqet e buta ishin ata që e nxitën Jehudën që të bie në shtrat me gruan e vëllait të tij të përmendur në Tevratë.

Kjo ishte pjesa e dytë e tregimit të Jusufit të treguar në Kur'an, ndërsa sa i përket pjesës së tretë, nuk e gjejmë as në librat tjera e as në Tevratë. Kështu pra Muhamedi s.a.v.s. ka qenë dashur që patjetër të ketë edhe libra tjerë përpos librave të sipërpërmendura, të cilat deri më sot ende nuk i kemi hasur, të cilat libra është e pamundur të ekzistojnë.

Atë që e treguam në tregimin e Jusufit është e njëjtë te të gjitha tregimet tjera në Kur'an.

Kjo specifikë në Kur'an (dëshmia e Kur'anit për librat e mëparshme) është shumë e rëndësishme sepse vijmë në përfundim në atë se është e pamundur që një njeri analfabet i cili jeton në një shkretëtirë (Muhamedi s.a.v.s.) t'i lexojë të gjitha faqet e secilit libër, të cilat deri më tani as që i kemi ditur se ekzistojnë. Pastaj të mënjanohet nga çdo detaj i palogjikshëm, pastaj ta marrë atë çka është e drejtë dhe e vërtetë, pastaj t'i paraqet rezultatet e tregimeve të sqaruara për mrekulli. E gjithashtu të gjitha këto t'i veprojë fshehurazi!!!

Kjo gjë është absurde, posaçërisht si i ka zbuluar librat sekrete (apokrifet) të secilit sekt apo grup fetarë.

“O pasues të librit, ju ka ardhur pejgamberi Ynë që t’ju sqaroj shumë gjëra të cilat ju i keni mbajtur sekret nga libri, dhe shumë gjëra t’ju falë. Nga All-llahu, veç ju ka ardhur drita dhe libri i qartë.” (El-Maide : 15).

KAPITULLI I KATËRT

Ne e pranojmë Islamin për shkak të mrekullive shkencore në Kur'an.

Kur'ani ka paraqitur dhe ka shpjeguar në formë të posaçme çështjet e gjeologjisë, biologjisë dhe astronomisë dhe asnjëherë nuk ka ardhur në kundërshtim me të vërtetat shkencore.

Tani ne po ju paraqesim të vërtetat shkencore të cilat argumentojnë se Kur'ani është mrekulli mbinatyrore.

a. Në çështje të Astronomisë

1. Kur'ani përmend se gjithësia është e krijuar prej një origjine të përbashkët të cilën sot e quajmë bërthamë, e cila nëse e përshkruajmë për së afërmi i ngjason mjegullimit të koncentruar në një pikë qendrore të nxehtë, këtë e përshkruan Kur'ani si mjegull: **“A nuk e dinë ata, të cilët nuk besuan se qiejt e toka ishin të ngjitura e Ne i ndamë.”** (Enbija : 30).

Mandej e mësyu qiellin (krijimin e qiellit) e ai ishte tym (mjegullinë që ishte si materie e parë) dhe atij (qiellit) e edhe tokës i tha: Qasuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë! Ato dyja thanë: **“Po i qasemi (nënshtrohem) me dëshirë.”** (Fusilet : 11).

2. Të shikojmë pra rrotullimin e tokës.

Çështja se toka është sferike, kjo çështje është e vërtetuar dhe është pranuar, këtë e ka përmendur Kur'ani: **“Ai natën ia mbështjell ditës dhe ditën ia mbështjell natës.”** (Zumer : 5).

Në gjuhën arabe kur të thuhet “Keverë Umamet” d.m.th. e ka pështjellur rreth kokës në formë Geoide. Këtë e kemi vërtetuar në shkencën bashkëkohore: se toka është sferike dhe se gjysma e saj kur është natë gjysma tjetër e saj është ditë dhe me rrotullimin e tokës nata e mbështjell ditën dhe po ashtu dita e mbështjell natën.

3. E ka vërtetuar shkenca se shuarja e yjeve është çështje shumë e vështirë dhe nuk është vetëm ashtu qysh e sheh syri ynë nga malet e larta. Ne faktikisht jemi shumë larg yjeve. Ne nuk i shohim yjet por vetëm i shohim format (figurat) ose shuarjen e tyre pas 1000 ose miliona vite dritë, pse udhëtimi i dritës i cili vjen prej yllit deri tek ne është shumë i gjatë edhe pse ka shpejtësi të madhe.

Thotë All-llahu i madhëruar: **“Betohem në shuarjen (perëndimin) e yjeve. E ai është i madh, sikur ta dini!”** (Vakia : 75,76).

4. Në vitin 1955 është paraqitur teorema e zanafillës së gjithësisë e ashtuquajtura “Bing Bang” që d.m.th. “eksplodimi i madh”. Kjo është në përputhshmëri të plotë me mendimin e astronomëve me teoremën e tyre “STEADY STATE THEORY” dhe atë në librin “Van Nostrandis Scientific Encyclopedia” në kapitullin “Cosmology” faqe 800 i cili është vërtetuar në vitin 1965 për eksplozimin e madh. Po ashtu të shikojmë në shkencëtarët britanez në kapitullin “Bing Bang Model” teoremë e cila thotë: Gjithësia ka filluar nga një toptë i zjarrtë me një nxehtësi tejet të madhe, pastaj ai toptë ka eksploduar dhe është formuar galaktika dhe është zgjeruar e cila edhe sot zgjerohet. Edhe sot galaktikat zgjerohen (largohen) deri sa të vijnë në fazën e fundit, apo kufirin maksimal (atëherë kur përfundon ndikimi i eksplozimit të madh dhe mbetet vetëm gravitacioni apo fuqia tërheqëse dhe prapë ndodhë ndeshja e madhe në mes të planetëve dhe prapë kthehet gjithësia në toptë të zjarrtë “Dictionary o geological terms”, 3rd ed. *Big Bang hypoThesis*. Më vonë nëpërmjet studimeve tjera është vërtetuar largimi i planetëve sikurse largohen edhe valët e radios. Me këto studime janë marrë edhe shkencëtarët e universiteteve të Harfordit, të Uashingtonit dhe Arizonës Fq. 801 “Van Nostrandis Scientific Encyclopedia, 6th ed.”.

Pra është vërtetuar shkencërisht se origjina e tokës ka qenë një toptë i zjarrtë, siç është vërtetuar po ashtu se bota është duke u zgjeruar dhe se influenca është më e vogël, pastaj mbet besimi teorik se zvogëlimi i influencës dhe zmadhimi i largësisë në mes trupave qiellorë e ka përfundimin e saj në forcën e vet gravitetit pastaj prapë do të ndodhë ndeshja e planetëve që të kthehet në gjithësinë në të cilën ka qenë edhe më parë në toptë të gaztë ose të zjarrtë.

Siç duket ky përfundim i gjithësisë nuk është më vetëm si teoremë e supozuar por me përdorimin e Teleskopit “Balmar” është parë se ka zbrazëtira në vijën e drejtë i cili është plotësisht i saktë me ligjin e “Habelit” i cili thotë se ekziston ngadalësimi i lëvizjeve në largimin e trupave (Fq. 801 po aty).

Këtë çka e theksuam më lartë e ka vërtetuar Kur'ani ku e përmend se gjithësia përfundon me kaplimin e saj (sa që do të ripalohen qiejt si fleta e librit apo si regjistri i paluar) dhe përkujton Kur'ani se gjithësia do të përfundoj aty ku ka filluar, pra ajo ka filluar me hapjen e saj dhe para këtij përfundimi gjithësia do të jetë në formën më të zgjeruar.

“(Përkujto) Atë ditë kur Ne e palojmë qiellin sikurse palimi i fletëve në libër. Sikundër e kemi filluar Krijimin e rrikthejmë” (Enbija : 104).

“Ata nuk e çmuan All-llahun me atë madhështinë që i takon, ndërsa, në ditën e kijametit e tërë toka është në grushtin e Tij e qiejt të mbështjellë në të djathtën (forcën) e Tij.” (Zumer : 67).

“Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë.” (Dharijat : 47).

Sipërfaqja e Hënës ka qenë e flaktë më parë, në kohën kur toka ka qenë e ngurtë, këtë e ka vërtetuar vetë shkenca. Për atë arsye secili trup i sistemit diellor ka qenë trupth i zjarrtë e pastaj është bërë i ngurtë, pas për afërsisht 4.6 bilion viteve. Mirëpo ato copëza nuk janë bërë të ngurta në të njëjtën kohë dhe menjëherë, por patjetër ka qenë dashur të kalojë nëpër etapa, derisa është kryer ai operacion dhe nga ato nuk kanë mbetur të zjarrta siç është dielli, copëzat të cilat janë ftohur më herët janë më të ngurta (forta). Është vërtetuar se planeti i tokës ka ftohjen më të lartë 5.52, pastaj Ataretun 5.4, ndërsa hëna e ka ftohjen 3.35 gr/S³. Pra për atë është ftohur toka para hënës. Ndërsa dielli ka qenë dhe ende është i zjarrtë. Pastaj ekzistojnë edhe dy dukuri të posaçme në ngurtësimin e hënës:

E para: hëna nuk është ftohur sikur toka, atom pas atomi, dhe palë pas pale, por ka qenë bashkim i të gjitha pjesëve të ftohura nga materia.

E dyta: dukuria e dytë është më e rëndësishme, ajo është zhvillimi gravitacionit të hënës me ngurtësimin e tij si rezultat i rritjes së madhësisë së sajë, e cila ka shkaktuar ndeshjen në mes veti të pjesëve shumë të mëdha dhe ka ardhur deri te nxehtësia shumë e madhe dhe kjo ka qenë dukuri e vetme e cila e ka bërë

pjesën e jashtme (150-200km) të zjarhtë ndërsa pjesa e brendshme e ngurtë (e nxjerrur nga libri “Physical geology” 2nd edition-flint and skinner-editor: John Wiley and sons Library of congress cataloging in publication data: Flint, Richard faster 1902 – 1976 physical geology p. 460, 463, 467, 472).

Thotë Zoti i madhëruar : **“Ne i bëmë natën dhe ditën dy fakte (që dokumentojnë fuqinë Tonë), e shenjën e natës e shlyem (e errësuam) e shenjën e ditës e bëmë të ndritshme” (Isra : 12).**

Shenja e natës është hëna, ndërsa shenja e ditës është dielli, këtë e transmeton Ibn Kethiri në komentimin e tij nga Ibn Abasi, dhe po ashtu e komenton Shevkaniu.

Pra Kur’ani thotë se dikur hëna ka qenë si dielli sot (e zjarhtë e cila reflekton dritën dhe nxehtësinë e saj në tokën e ngurtë, pastaj edhe ajo është ftohur dhe është bërë e ngurtë).

Është interesante se disa libra jehude para Kur’anit si “Apocalypse of Barueh” e përmendin këtë mrekulli shkencore mirëpo është përzier me besëtytni ku përmendë se qiejt, dielli, dhe yjet janë pikëlluar për daljen e Ademit nga Xheneti në hënë e cila ka qeshur për të dhe Zoti e ka dënuar me marrjen e dritës prej saj!!! Nxjerrur nga libri “ The legends of Jews” Adam 92.

b. Gjeologjia

1. Ne jemi të sigurt se para 3,8 bilion viteve (kur toka ka qenë e ngurtë) sipërfaqja e tokës ka qenë e mbuluar me ujë, dhe sasia më e madhe e ujit është vendosur nën sipërfaqen e tokës. Gjatë formimit të xeheve këto ujëra kanë arritur mbi sipërfaqe si të ishin dete të vluar nga shkaku i shpërthimit të vullkaneve të hershme” Marrë nga libri “Physical geology” Flint and Skinner P.308-309 2nd edition.

Kjo është çka e ka theksuar Kur’ani. **“Dhe pastaj tokën e sheshoj (e rrafshoi) dhe prej saj e nxori ujin e saj dhe kullosat e saj”.**

Secila kodër patjetër duhet t’i ketë rrënjët e ngulitura në thellësi të tokës e cila e baraspeshon lartësinë e saj. Zakonisht thellësia e rrënjëve të kodrave është varësisht prej lartësive të saja në proporcion 10 metra më shumë ose më pak (këtë mund ta shohim në çdo libër gjeologjik ose historik ose struktural, “Historical geology and structural geology” në temën “Plate Tectonics”).

2. Teorema e cila tregon për rrëshqitjen e maleve, dhe lëvizjeve horizontale ashtu që ndeshen kodrat të mbuluar me ujë kështu që rrëshqet një pjesë e malit (e cila është më shumë e ftohur) nën tjetër dhe formohen malet vullkanike “Island arc” pastaj mblidhen këto male vullkanike dhe bëhen shkëmbinj të fortë, shkëmbinjtë e fortë nuk ndalen kur të ndeshen me shkëmbin tjetër të ri (Collisional type mountain). Lëvizjet vertikale të tokës në të kaluarën kanë qenë më të mëdha se sot. Rezultat i kësaj është ngurtësimi dhe ftohja e shtresës së tokës më shumë se në të kaluarën dhe për shkak të rrezeve radioaktive më të dobëta.

Pra, malet janë shtylla (rrënjë) dhe roli i tyre është mbajtja e mosçarjes së sipërfaqes së tokës, ndërsa kjo realizohet vetëm nëpërmjet rrënjëve (shtyllave) të thella dhe sikurse edhe malet (kodrat) janë të krijuara ashtu edhe shtresa e tokës (toka) në të

kaluar është krijuar. (Souces of scientific knowledge . Z.R. EL. Naggar P.40. The geological concept of mountains in the Quran) The International Institute of Islamic thought.

Këtë e lexojmë në Kur'anin fisnik:

“A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme (për jetë), ndërsa kodrat shtylla?” (Nebeë : 6,7)

“A nuk e kemi bërë tokën shtrojë, kurse malet shtylla. Dhe Ai ka shpërndarë kodra (të forta) në tokë ashtu që ajo të mos lëkundet me ju.” (Nahl 15).

3. Toka përbëhet prej disa shtresave të ndryshme. Në përgjithësi shtresat ndahen në tri lloje. Sipërfaqja e tokës, pjesa e mesme dhe bërthama. Pastaj ekziston edhe ndarje më e imtë, e ajo ndarje përbëhet prej pesë shtresave e më shumë. Këto shtresa edhe pse ndryshojnë njëra me tjetrën në përbërje ato janë në funksion të përbashkët gjithmonë, p.sh. shtresa e sipërfaqes, ajo rrëshqet dhe disa pjesë të saj hyjnë në pjesën e mesme, po ashtu sikurse pjesa e mesme e cila është e përbërë me shkëmbinj depërtojmë në thellësi të sipërfaqes së tokës ose e nxjerr llavën vullkanore prej pjesës së mesme nëpërmjet vullkaneve mbi sipërfaqen e tokës. Kështu, pra shtresat e tokës gjithmonë janë në influencë të njëra-tjetrës.

Pra, shkenca po e vërteton se toka është e përbërë me shtresa të cilat shtrihen njëra mbi tjetrën dhe këto janë në funksion të përbashkët, këtë e shohim në Kur'an: **“All-llahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej e edhe prej tokës aq sa ata, në to zbatohet vendimi i Tij për ta ditur se All-llahu ka fuqi për çdo send, dhe që me të vërtetë All-llahu ka përfshirë çdo send me dijen e Vet.”** (Talak : 12)

Kur'ani thotë se janë shtatë palë qiej dhe po ashtu edhe toka përbëhet prej shtatë palëve sikur ata. Kur'ani po ashtu edhe në shumë vende tjera sinjalizon se janë shtatë palë qiej të cilat janë të shtrira njëra mbi tjetrën. Po ashtu edhe toka sikurse qielli që d.m.th. se është e përbërë prej shtatë shtresave, ndërsa fjala e All-llahut: **“Në ta zbatohet (urdhri) vendimi i All-llahut.”** Kjo

vërtetë është mrekulli, pse këto shtresa nuk janë statike por gjithmonë janë dinamike, gjithmonë janë në funksion njëra me tjetrën kur të jenë të urdhëruara duke e zbatuar vendimin e Allahut.

4. Shumica e xeheve prodhohen nga procesi i ujit të cilat e kanë thithur nga depërtimi i ujit prej lumenjve *Placer deposits* ashtu që uji rrebesh si rezultat i shirave të mëdha nga kodrat me lartësi të larta mbidetare të cilat në vetvete mbartin rërë e cila rërë ka përbërje të shumtë të xeheve të çmuara dhe të metalta të cilat xehe quhen “*Mother Rock*” (rëra bazë), të cilat janë xehe të çmuara (gurë të kristaltë). Zakonisht gjenden në male të larta të cilat janë të mbuluara me shtresë të dheut dhe copëtohen (Rogolith). Kur të bie uji në këto shtresa të dheut prodhohet yndyrë (pluhur) si rezultat i përzierjes së kripërave të xeheve të përbëra nga ato copëza dheu. Nëse uji është më i vrullshëm forcohet në copëzën e rërës bazë dhe formohet varësisht prej ujit sa është i furishëm apo nuk është i furishëm, pastaj pjesët të cilat ndahen nga guri i çmuar bazë, e vazhdojnë rrugën e tyre së bashku me ujin deri në pjesët e tokës të cilat janë më të rrafshëta, dhe më të ulëta.

Sa i përket xeheve jo të kristalta të gjendura në këto pjesë të cilat janë të mbështetura në rërë (gurë të çmuar, nuk mund ta vazhdojnë rrugën, por fundosen në fund të ujit dhe krijohet lym në vete, ashtu siç janë formuar copëzat e para, të cilat edhe pse kanë qenë të pështjellur, kur kanë rënë prej kodrave në ujë, ndërsa xehet e kristalta i përballojnë (procesit) udhëtimit të ujit, bile ato pastrohen edhe më shumë, aq sa zgjatë udhëtimi (procesit) dhe bashkohen copëzat dhe shihen me sy, tre milion herë më pastër se sa ka qenë rëra për të parën herë. A nuk është kjo të cilën e lexojmë në Kur'an?: **“Ai e lëshon ujin (shiun) nga qielli e sipas madhësisë së tyre rrjedhin përroska, kurse vala bartë mbi vete shkumë të fryrë lartë. Shkuma e ngjashme është edhe ajo kur shkrihet (metali) në zjarr për të përfituar ndonjë stoli ose ndonjë mjet. Kështu, All-llahu sqaron shembullin e të vërtetës dhe të pavërtetës. Për sa i**

përket shkumës (së ujit apo metaleve), ajo hidhet si mbeturinë, ndërsa ajo që u sjell dobi njerëzve, ajo mbetet në tokë. Kësisoj All-llahu i sjellë shembujt.” (Err Rad : 17).

Në komentimet e më hershme është thënë se ky ajet sqaron dy çështje: E para - ujërat janë prej shiut. E dyta - farkëtari e nxjerr xehen me zjarr. Ndërsa ajeti vazhdon : **“...ndërsa ajo që u sjell dobi njerëzve ajo mbetet në tokë.”**. Farkëtari mjetet, xehet prapë janë mbi tokë. Pra këta: edhe xehet edhe uji e kanë një operacion.

Atë çka e tregon ajeti, hadithi sherif e sqaron. Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebi Hurejrete r.a. se i dërguari i All-llahut kur ka folur për arin ka thënë se gjendet në lumë (në brendësi të ujit apo lumit). ***“Është e mundur (kam frikë) se lumi Eufrat të humbë thesarin e arit, kush është aty mos të merr, prej shenjave të ditës së kijametit është se toka do të nxjerr vlerat (rëndësinë) nga brendësia e saj.”***

5. Është e njohur se retë janë të llojllojshme. Disa prej tyre shkojnë vertikalisht dhe kanë forma të ndryshme, dhe ndryshojnë prej faktorëve të ndryshëm siç janë retë (cumulus) (këto re palohen njëra mbi tjetrën). Këto re ngrihen lartë dhe zbresin poshtë, kur të zbresin poshtë zbresin në lartësi 500-1000 hapa, mirëpo prej poshtë lart mund të jetë gjatësia e tyre 20 000 hapa (6096 metra). Këto re përbëhen nga uji dhe bora. Nga ky lloj i reve degëzohet reja e quajtur “Reja e mbushur plot shi”.

Këto re janë shkak i vetëtimës dhe murmurimës (Thunderstorm clouds).


Këto re përbëhen prej ujit dhe borës, pra bie shiu dhe bora prej tyre. Këto re rriten vertikalisht dhe duken si male e kodra (lartësia mund të arrijë deri në 50 000 kuti) ose duken si me qenë objekte të mëdha dhe prej tyre pastaj formohen retë tjera degëzore (shih “Van Nostrand’s Scientific Encyclopedia” P.679).

Po ashtu edhe retë e quajtura “Cumulunimbus Capilatus” janë të këtij lloji dhe janë re të borës (Dairetul Mearif el-Britanie, Kapitulli Clouds).

Këtë e shohim në Kur'anin fisnik: **“A nuk i ke parë se si All-llahu drejton retë, pastaj i bashkon, i bënë grumbull ato dhe atëherë e sheh shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon prej së larti, nga retë e mëdha si kodra breshër dhe me të godet kë do, e ia largon atij që do, e shkëlqimi i vetëtimës së dritës së resë gati se s’të merr të parit.”** (En Nurë : 43)

c. Në shkencën detare

1. Që në fillim njeriu e ka ditur se ekzistojnë valët sipërfaqësore të deteve. Mirëpo ai nuk e ka ditur se ka valë të brendshme “Density current” të cilat janë rezultat i shtypjes dhe kondensimit në mes të ftohjes dhe shtimit të nxehtësisë.



Skema e Oqeanit Atlantik

Kjo figurë tregon rrymat e brendshme detare (brendësinë e Oqeanit atlantik) shkronjat latine

janë shkurtesa të llojeve të rrymave detare p.sh. N.A.D.W (North Atlantic Deep Water) d.m.th. ujërat e thella të atlantikut verior. MW (Mediterranean Water) d.m.th. ujërat e detit të kondensuar në brendi të oqeanit atlantik. Kjo e fundit ka rëndësi të posaçme sepse ajo vërteton përzierjen dhe mospërzierjen e kufizuar në mes të deteve e cila është e përmendur në Kur'an ku do të tregojmë në temën që vijon.

Po ashtu njeriu deri vonë nuk ka ditur për errësirën e thellësisë së detit e cila është si rezultat i thyerjes së ngjyrave në thellësi të detit. Pas tridhjetë metrave paraqitet ngjyra e kuqe ndërsa pas dyqind metrave paraqitet errësira e fortë ku ekzistojnë peshq të cilët nuk mund të shihen por vetëm nëpërmjet peshqve tjerë të ndriçuar nga vetvetiu. Këtë e konstaton libri i shkencave në det “Oceanography” ose “Marine biology”.

Këto dukuri të vërtetuara shkencërisht (valët e brendshme të detit dhe errësira e thellësisë së detit) i lexojmë në Kur'anin

fisnik: **“Ose janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valë mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai (njeriu) as dorën e vet. Atij të cilit All-llahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë”** (En-Nurë : 40). *Vërejtje: Në ajet nuk është përmendur errësira e natës por errësira e mjegullave të detit.*

2. Detet e hapura të ngjitur njëri me tjetrin nuk janë të njëllotë siç mendojnë shumica e njerëzve sepse aty pikë së pari ka dallim në elementet ekzistuese në ta, pastaj në shkallën e nxehtësisë së tyre dhe të kondensimit dhe në përqindje të oksigjenit dhe llojet e gjallesave në ta, pastaj në përqindjen e kripës (p.sh. Deti i kuq ka më së shumti kripë). Këto i lexojmë në shkencën e Oqeanëve “Oceanography” ose “Marine Biology”.

Përpos kësaj sipërfaqet e mëdha të deteve ndahen në shumë lloje dhe në momentin e bashkimit të dy deteve bëhet vetëm përzierje e pjesshme, pa e ndryshuar gjendjen e mëparshme asnjëri prej deteve. Këtë përzierje e dirigojnë faktorët e valëve të brendshme të detit. E kemi cekur më parë se uji i ftohtë ose me përqindje më të madhe të kripës lëvizë në thellësi ndërsa në të kundërtën në sipërfaqe. Përkundër këtyre përzierjeve të pjesshme prapë se prapë uji i ruan veçoritë natyrore të saj të cilat kanë qenë edhe më parë. Kjo kuptohet edhe më mirë në detet me rreze të kuqërremta (Thermal mapping) kur në Qershor të vitit 1982 nëpërmjet satelitit është parë deti në tërësi i kuq dhe ka arritur nxehtësinë 25°C. Po ashtu edhe deti i kuq është dukur si i verdhë me nxehtësi 25.5°C. Ndërsa Oqeani Indian i kaltër me nxehtësi 23°C. Po ashtu edhe deti Mesdhe ngjyrë të verdhë me të gjelbër dhe po ashtu edhe Oqeani Atlantik (“The Cambridge Encyclopedia of Space” ed: Michael by croft).

Të gjitha këto forma tregojnë dallimin e pjesëve të deteve me cilësi të veçanta. Mirëpo nuk tregohet ndonjë kufi (ndarje) i vogël i cili ndodhet në mes tyre. Për shkak se kjo tregohet në mënyrë të përgjithshme, mirëpo ky kufi (kjo ndarje) ekziston edhe më thuktë dhe është më i qartë, mirëpo kjo përzierje të cilën e kemi përmend dhe ky dallim është shkak i rrymave të

brendshme detare dhe këto janë veçori të pjesëve të veçanta detare. Shih fotografinë ku shihet qartë deti Mesdhe dhe Oqeani atlantik. Këtë e lexojmë në Kur'anin fisnik: **“Ai i lejoi dy detet të puqen ndërmjet vete. Ndërmjet atyre të dyve është një pengues që ata dy nuk e kapërcejnë.**



E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni? Prej atyre të dyve nxirren margaritarë e diamante.” (Err-Rahman 19, 20, 21,22). Fjala “El-Merexh” do të thotë përzierje, ndërsa fjala “berzeh” do të thotë perde (pengesë), ndërsa fjala “La Jebgijani” do të thotë se kjo përzierje është e kufizuar me kufi të posaçëm, ndërsa fjalia “Jahruxhu minhumel-luëluë vel merxhan” vërteton se që të dy detet janë të njelmët sepse diamanti nxirret prej ujërave të njelmët.

d. Embrionologjia

Koha e mesjetës ka qenë e përmbushur me plotë besëtytni sa i përket kësaj çështje të cilat nuk kanë pasur kurrfarë mbështetje apo argumenti sa që edhe pas epokës së mesjetës disa shekuj me radhë ka pasur të njëjtin trajtim. Zanafilla e kuptimit të plotë sa i përket embrionologjisë ka filluar në vitin 1651 kur HARFI e jep mendimin e tij se çdo gjë e gjallë së pari formohet prej vezorit e pastaj embrioni gradualisht zhvillohet pjesë pas pjesë (etapë pas etape). Këtë e konstaton mjeku akademik francez Mouris Boukall në librin i tij “Kur’ani, Tevrati, Inxhili dhe shkenca”. Ndërsa shikoni se si Kur’ani fisnik e tregon zhvillimin e embrionit:

“Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar për ta sprovuar atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë.” (El- Insan : 2).

“Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët.” (Es-Sexhde : 8).

“O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë mendoni për krijimin tuaj që Ne u krijuam juve prej dheu, pastaj prej ujit (spermës), pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej copëzës së mishit (embrionit) në formë të plotë (të qartë) dhe jo të plotë (të paqartë) në mënyrë që t’iu sqarojmë.” (El-Haxh 5).

“Vërtetë, Ne e krijuam njeriun prej lëngut të baltës (thelbit të tokës), e pastaj (e krijojmë) si pikë fare në një vend të sigurt, e pastaj atë pikë uji e bëjmë copë gjaku, e atë gjak të n’trashur e bëjmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërrojmë në eshtra, e mandej eshtrat i veshim me mish, e pastaj e ngjallim si krijesë tjetër. I lartë është All-llahu, më i miri Krijues!” (El Muëminunë : 12-14).

Cilësimi i lëngut të burrit (spermatozoidit) si lëng i bashkëdyzuar, i cili është përmendur (në ajetin e parë) në Suretul Insan, konsiderohet si njohuri e veçantë, të cilën ne veç sot e kemi mësuar se sperma përbëhet prej elementeve të ndryshme, nga shkaku se ajo prodhohet prej një grumbulli

hedhesh, të mashkullorëve dhe spermatozoideve dhe pjesëve tjera nëpërmjet kanalit të urinës (Mauris Bukall, faqe 229).

Ajeti tjetër në Suretu Sexhde ajeti 8 se pasardhësit burojnë nga pika e dobët e ujit, pra nga sperma, na bën të ditur se një spermatozoid prej dhjetëra milionave të ngjashme është ai i cili mbarëson vezorin, përderisa elementet tjera të spermës asimilohen dhe zhduken gjatë rrugës duke kaluar prej kanalit të organit mashkullor e deri te vezori në mitër ku aty thahen – *Buk Kalub* (Ibid fq.230).

Ajeti tjetër në Suretul Haxh tregon se disa pjesë të gjakut të ngjizur (në fazën e embrionit) i ngjasojnë mishit me gjak të ngjizur (është faza e embrionit i cili i ngjanë copës së mishit), që më pastaj fillon të formohen dhe të dallohen pjesët e foshnjës (trupit të foshnjës). Ndërsa disa pjesë vazhdojnë të mbesin siç kanë qenë (të paformuara). Kjo përputhet plotësisht me shkencën e embriologjisë sepse pjesët e pa formuara qëndrojnë si pjesë rezervë strategjike, për t'ia kompensuar trupit çështjet të cilat i mungojnë dhe të cilat i nevojiten gjatë gjithë jetës. (Botuar në revistën “Ahbarul jevm” 36.2.1994 fq. 14 nën titullin “Dijetari Kanades përgatitë librin shkencor për embriologjinë, duke argumentuar me ajete kur'anore”. Ky dijetar kanadez quhet Dr. Keith I. Moore i cili kohë më parë e ka pranuar fenë Islame. Në gjuhën angleze libri titullohet “The developing human-with Islamic additions” 3rd edition “Zhvillimi i krijimit të njeriut (embrionit) siç parashihet në Islam”. Ky dijetar është profesor dhe dekan i katedrës në fakultetin e mjekësisë së universitetit “Toronto” në Kanadë.

Sa i përket çështjes së katërt është prej argumenteve më të fuqishme shkencore të mrekullisë së Kur'anit, pasi që tregon fazat kryesore të zhvillimit të embrionit. Renditja (krijimi) fillon prej “spermës”, më pastaj pas dhjetë ditëve vezorët marrin rrugën brenda mureve, në këtë fazë embrioni saktësisht i ngjanë gjakut të ngjizur (Ibid). Kur'ani e ka quajtur po me këtë emër, pas kësaj embrioni fillon të lëvizë në mitrën e nënës. Në këtë fazë embrioni saktësisht i ngjanë copës së mishit, ku shihen shenjat e

dhëmbëve. Kur'ani me të drejtë këtë fazë e ka quajtur “copë mishi” (Ibid).

Pastaj në javën e tretë fillon të paraqitet forma e foshnjës, fillojnë t'i paraqiten eshtrat e fytyrës, të mbuluara me një cipë të hollë lëkurore prej së cilës janë të tejdukshme pjesët e eshtrave (“Van Nostrand’s Scientific Encyclopedia” p.10088). Kjo është faza e formësimit të eshtrave siç e ka përshkruar “Kur’ani”, pastaj formohen pjesët tjera në të dy anët (Ibid). Kjo është faza siç e përshkruan Kur’ani: **“Dhe Ne i veshim eshtrat me mish”**.

Pas javës së tetë embrioni duket plotësisht si njeri, ndërsa para kësaj kohe nuk mund të dallohet embrioni i njeriut prej atij të derrit apo të cjamin apo të qenit apo të majmunit (Ibid fq. 1089). A nuk është ky interpretim i fjalës së Zotit të Lartmadhëruar i cili në pjesën e fundit të formimit të embrionit thotë **“...pastaj Ne e rifillojmë krijesë tjetër”**.

Kështu pra, a nuk është kjo mrekulli shkencore e Kur'anit. Raste të tilla të shumta do të zbulohen edhe në të ardhmen.

Është interesant se Kur'ani thellohet aq shumë në shkencë dhe është në përputhshmëri me të gjitha lëmit shkencore.

KAPITULLI I PESTË

Ne e pranojmë Islamin për shkak të paralajmërimeve në Kur'an të cilat më vonë janë vërtetuar.

Kur'ani ka paralajmëruar për çlirimin e Mekës dhe për mos pranimin e Islamit të Ebu Lehebit. Mirëpo prej paralajmërimeve më të rëndësishme është për fitoren e Bizantinëve kundër Persianëve pas disfatës së tyre por çka është më interesante përcaktimin e fitores për disa vite (7 deri në 9 vite).

Në emër të All-llahut, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit.

“Elif Lam Mimë. Bizantinët pësuan disfatë në tokën më të afërt (arabe) por ata pas disfatës së tyre do të korrin fitore (do të triumfojnë). Brenda disa (7-9) viteve. Çështja është se ky është vendim i All-llahut fillim e mbarim (për disfatë e për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë Bizantinët) besimtarët do të gëzohen për ndihmën e All-llahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Gjithëfuqishëm, Mëshirues. (Ky është) Premtim i All-llahut, All-llahu nuk e thyen premtimin e vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Ata dinë vetëm anën sipërfaqësore të kësaj jete ndërsa për jetën tjetër janë të pakujdesshëm (indiferent).” (Err-Rrumë 1-8).

Është interesante thënia e orientalistit Wherry në librin e tij “Commentary on the Qur'an” në lidhje me paralajmërimin e kësaj ngjarje në komentimin e sures Err-Rrumë se paralajmërimi të tilla nevojiten për çdo ditë dhe kërkohen për çdo ditë si p.sh. në politikë!? Pastaj vazhdon Wherry e thotë: Si mund të rrezikojë njeriu të thotë se jam peygamber e pastaj të jep një paralajmërim të tillë e të rrezikshëm dhe jo vetëm këto por edhe e cakton momentin e ndodhjes në një afat të shkurtë përveç kësaj persianët kishin korrur fitore të madhe e bizantinët kishin pësuar disfatë katastrofale dhe si është e mundur për një periudë të shkurtë (7-9 vite) me i radhitë forcat e veta. Po mos të ndodhte ky paralajmërim do të pësonte misioni i peygamberllëkut plotësisht. Por romakët prapë çliruan vendet e tyre dhe ata u kthyen deri te muret e Konstantinopolisit deri në vitin 622 të epokës së re. Pra deri sa Herakliu me ushtrinë e tij

doli në atë vend dhe natyrisht kjo ka qenë fitore e romakëve. Ndërsa kjo fitore ka qenë pas disa viteve të disfatës.

Atë çka nuk e ka kuptuar orientalisti Wherry dhe të tjerët është se Kur'ani nuk është ndalur vetëm te ky paralajmërim, pra nuk e ka paralajmëruar vetëm fitoren e romakëve. Por ka paralajmëruar se do të ngadhënjejë deri në "Ednel Erda" pra deri në vendin e parë. Nëse thua se kam ardhur në shtëpinë tënde dje, e do të vij edhe nesër, kuptohet menjëherë se do të vij edhe nesër në shtëpinë tënde, e jo në ndonjë shtëpi tjetër¹¹.

Ashtu qysh e ka paralajmëruar fitoren e romakëve, ka paralajmëruar edhe fitoren e muslimanëve në luftën e Bedrit. Argument për këtë kemi pjesën e ajetit kur'anor: **"Dhe atëherë do të gëzohen besimtarët, me fitoren e All-llahut"**. Humbja e romakëve ka qenë ditën e Bedrit. Këtë e kanë treguar Ibn Abasi, Eth-Thevriju, Sudaiju dhe të tjerët. Këtë e vërtetojmë në hadithin e Tirmidhiut, Ibn Xheririt, Ibni Ebi Hatemit, dhe Berazit (Tefsiri Ibni Kethirit – Për Zotin këtu nuk është fjala për fitoren e romakëve ndaj persianëve, sepse romakët janë pasues të librit. Që të dy Kur'ani i ka cilësuar jobesimtarë. Po ashtu nuk mund të komentohet pjesa e ajetit "gëzim i muslimanëve me fitoren e All-llahut" sepse gëzimi ndodh për shkak të paralajmërimit. Muslimanët kanë qenë në Medine. Ata kanë emigruar prej Mekës në Medine, ndërsa paralajmërimi ka qenë në Meke, e idhujtarët Kurejsh ende kanë vazhduar në idhujtarinë e tyre pas këtij paralajmërimi. Këtë e vërteton Zoti i Lartmadhëruar kur thotë "Premtim prej All-llahut" e premtimi i All-llahut nuk është për Persinë, as për Romakët, po për muslimanët dhe besimtarët¹².

Atë të cilën nuk e ka kuptuar orientalisti Wherry dhe të ngjashmit me të është se fjala "Ednel Erdi" toka më e afërt dhe më e poshtme të cilin vend e ka përcaktuar Kur'ani është Palestina i cili është kuptim i fjalës "Ken'an". Pra "Ken'an" është emër i Palestinës sipas gjuhës së banorëve vendas "Ken'anejn". Para se të shkonin beni israilët në Palestinë. Pra ka qenë më herët "Ken'an" ose Toka Ken'an që ka kuptimin "Toka e poshtme e ulët". Kush ia ka mësuar Muhamedit s.a.v.s. kuptimin e fjalës Ken'an. Në shkencën topografike është vërtetuar se pjesa me e

ultë e planetit të tokës është hapësira e pjesës së tokës së detit të vdekur në Palestinë, e pas saj liqeni Taberi i cili gjithashtu gjendet në Palestinë.

Të shikojmë fotografinë:

Në këtë fotografi shihet qartë pika e ulët e hapësirës së detit të vdekur përballë vendeve tjera të ulëta. Ky vend është po ai vend për të cilën është përcaktuar dhe është përmend.

Atëherë kjo pjesë e shkurtër e ajetit të Kur'anit (në fillim të Suretu Rrumë) na tregon për 5 sekrete, që deri atëherë kanë qenë të panjohura:

1. Triumfin e romakëve ndaj Persisë.
2. Përcaktimin e vendit “Në vendin më të ulët”.
3. Përcaktimin e afatit për disa vite (edhe pse pra është përcaktuar afati shumë i shkurtër prapë se prapë është realizuar).
4. Triumfi i muslimanëve në të njëjtën kohë (në luftën e Bedrit) edhe pse ka edhe variante tjera.
5. Informimi për kuptimin e fjalës “Toka (hapësira) më e ulët”, pra ashtu siç e kanë quajtur vet banorët e atij vendi. Pra konfirmimi për këtë emër, dhe vërtetimi i atij emri edhe shkencërisht.



KAPITULLI I GJASHTË

Ne e pranojmë Islamin për shkak të paralajmërimeve të qarta për pejgamberin e Islamit s.a.v.s. në librat e shenjta të pasuesit të librave të shpallura.

(Në bibël) Te Sabiinët, (Kanzarija) te Zurda, te Shitijet (Zendafesta), te Hindusët (El Fijda).

Po ashtu Pejgamberi i Islamit s.a.v.s. është i paralajmëruar në Telmud, në Mijdarishe, në Sudë të Bigrafes (është libër i jehudëve para zbritjes së Kur'anit). Në Apokrifet (libër sekret i krishterëve të paraislamit) në të cilin libër ka argumente për Qaben¹³, për kevtherin¹⁴, për pejgamberin e fundit i cili do të vijë më vonë¹⁵, po ashtu në këtë libër ekziston fjala Islam¹⁶. Në këtë libër ka paralajmërimet për kohën kur do të lind ky pejgamber i mëvonshëm¹⁷ dhe cilësitë e tij¹⁸ dhe për triumfin e tij ndaj mbretërive të mëhershme e posaçërisht ndaj perandorisë Romake¹⁹, dhe për librin i cili do t'i zbres atij²⁰, dhe po ashtu për emrin e tij²¹.

Fusnotat:

1 - E dimë se: Triniteti te të krishterët është se tre zota janë një, e që e kundërta është te idhujtarët të cilët besojnë në shumë zota të ndryshëm te të cilët mbështetet njëri te tjetri. ("MIN IËXHAZUL KUR'AN FI EAXHEMIJUL KUR'AN" autor: Reuf Ebu Seade. fq. 334 vëll. i dytë.)

2 - Disa sekte të vjetra krishtere (të shek. të parë) si f.v. Basilët, besonin se e kanë marrë formën e Mesihut dhe ia kanë dhënë formën e një fshatari dhe e kanë kryqëzuar në vend të Mesihut i cili është ngritur në qiell." ("Tarihë urtukat mea dahdiha", autor: Fransis Marijadi Likuri)

Kështu mendojnë edhe të sektit të krishterë Carpotrates.

Po ashtu është edhe në Kur'an: **"Madje për shkak të thënies së tyre: - Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e All-llahut. Po ata as nuk e mbytën, as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytën atë. Përkundrazi, All-llahu e ngriti atë pranë Vetes. All-llahu është i Plotfuqishëm, i dijshtëm."** (en-Nisa: 157-158)

Kështu e përshkruan Kur'ani mënyrën e kryqëzimit të Mesihut apo Isait a.s. Është çështje e dyshimtë, e pasigurt dhe vetëm hamendësuese. Këtë mund ta vërejë edhe lexuesi i Inxhilit. Inxhili sipas Markut përmend se "Të gjithë nxënësit e Mesihut kanë ikur dhe e kanë lënë të vetëm Mesihun, me fjalë tjera nuk e kanë parë ngjarjen." Këtë e ka komentuar Karl Xhebxhebiri, dekan i fakultetit të Historisë në Paris në librin e tij. "Krishterimi, zanafilla dhe zhvillimi i saj." fq. 38. Botues: "Darul Mearif", ku thotë: "Është e mundur që shumica e ngjarjeve, posaçërisht sa i përket kryqëzimit e kanë humbur qartësinë e tyre në mendjet e besimtarëve para shkrimit të Inxhilit dhe në opinionet e tyre kanë ndikuar shumë proverba të ndryshme të përhapura në lindje, pastaj janë interpretuar në mënyra të ndryshme saqë e kanë humbur thelbin e ngjarjes."

3 - Prej këtyre argumenteve është se dijetari lahutist Johana Damaskij i është përgjigjur kritikëve të ikonave të cilët thonë se në librat e shenjtë nuk pranohet:

“Ju, gjithashtu nuk mund të gjeni trinitetin, ose çështjen djalë, ose babë, ose dualitetin e natyrshëm në librat e shenjtë, pos që ne e dimë se këto bindje janë të vërteta”. (“Usturetu texhesud ila fi sejid el-Mesijh” Xhon Hejk fq. 21. Darul Kalem.)

4 - Kuptimin e pjesës së fundit të këtij ajeti e gjen në Inxhilin e Gjonit : 17:12:13:

“Kur isha me ta e kam ruajtur në mesin e tyre emrin tënd... por, tani jam kthyer te ti.”

5 - Në lidhje me këtë, prifti Dr. Xhon Lormer në librin e tij “Historia e kishave” fq. 41 thotë: “Dhe derisa e panë atë në kodër, të paraqitur, nuk kanë menduar asgjë tjetër se është përpos një pejgamber prej pejgamberëve. Përderisa dështimin dhe humbjen të cilën e përjetuan, ata kanë menduar për dorëzimin, gjykimin dhe pastaj kryqëzimin, dhe atëherë u sprovuan dhe e kuptuan atë organizata themelore e cila është bërë cilësi themelore kishtarë”.

Po ashtu Çarl Xhinber, dekan në fakultetin “Historia e feve” të universitetit të Parisit në librin e tij “Krishterizmi, zanafilla dhe zhvillimi i saj”. fq. 141. shkruan: “Për këtë arsye, është hiperbolizim thënia se Pali është themelues i vërtetë i krishterizmit, sepse themelues të vërtetë të krishterizmit janë njerëzit të cilën e kanë ndërtuar kishën e Antakisë, vetëm se specifikë e Palit ka qenë se ai ka qenë më aktiv dhe më i gjithanshëm”.

Siç e përmend edhe Fransis Jong (Në ligjëratën për studimin e Inxhिलave në universitetin e Birminghamit) po ashtu në librin “Astura e shpirtëzimit të Zotit në Isën Mesihë”, fq. 163 se “Krishterët e ri grek, të cilët flasin greqisht, janë ata të cilët, Isën Mesijh e kanë shndërruar në Jehudij nga Palestina, në krijesë Zot të shpirtëzuar dhe kështu e kanë cilësuar pasuesit Jehud, pra Mesijh. Me këtë cilësi të turbullt ka depërtuar derisa ka arritur në kisha të ndryshme të jehudëve dhe te të tjerët, derisa ka arritur te pika e trinitetit.” (Xhon Hake, profesor në universitetin, Birmingham në librin “The myth of God incamate”)

Është interesante se në shek. XVIII, sa i përket krishterizmit, udhëheqësit e Renesancës në Evropë, e ndajnë të njëjtin mendim me ne. Ata thonë: Tregimet e Inxhilit janë besëtytni, doke dhe zakone, tregime të dëshmorëve, dhe tregime përrallore .

Mbi këto çështje është themeluar kisha krishtere. Kështu thotë edhe Bedijr: “Feja krishtere është ndërtuar mbi bazën e besimit të kotë, është prej feve më të errëta, ku shumica në të është urrejtje e cila shkakton të keqe të përgjithshme, shumica e saj është fatkeqësi, shumica e saj tregon parime fëmijërore të edukatës, shumica e saj tregon për fanatizëm”. Imanuel Kanti thotë: “Nuk duhet t’i përmbahemi besimit të krishterë, besimit të tij, apo besimit në Mesihun si Zot dhe si sakrifikues. I krishteri beson se Mesihu është kryqëzuar për të falur gabimet e njeriut”.

(Ref: Libri “Historia e krishterimit”, autor prifti: Xhon Lormer. Vëllimi i pestë, Botues : Daruth-Thikajeti)

Është interesante se këto janë mendime të priftërinjve të njohur të Shek. XIX.

Personaliteti gjerman Shtrause i ka mohuar mrekullitë e Inxhilit kur ka thënë: “Meta, Luka dhe Gjoni nuk e kanë shkruar Inxhilin, por e kanë shkruar të tjerët dhe se jeta e Jezusit është përshkruar nga proverbat të cilat i kanë shpikur shkruarit e Inxhilëve.” Siç ka shkruar Kebrik Xharil themelues i asaj që quhet: “Orthodoksizmi i ri Evropian” ref. Ibid . “Shkrimi i besimit të krishterë”.

Kjo qasje ka vazhduar në atë drejtim sa që ka rezultuar botimin e librit në vitin 1977, ku gjashtë dijetarë e kanë shkruar librin me titull “Asturetu texhes-sud ilahi fi sejjidil Mesijh” (shtëpia botuese: Darul Kalemi, Kuvajt) të cilët e mohojnë besimin e shpirtëzimit, etj., nga besimet krishtere, bile kanë thënë se bazat e besimit të tillë i kanë rrënjët në Budizëm dhe te të tjerët.

Në hyrje të këtij libri fq. 24 thonë se “(Inxhili) nuk e meriton të lexohet.”

Ekziston edhe një numër tjetër i të krishterëve, nga dijetarët dhe nga të tjerët, të cilët mendojnë se duhet larguar nga idetë e tilla, deri sa ka arritur në nivelin sa që kanë dalë në votim, ku 21 nga 29 peshkopë anglez kanë votuar pro kësaj iniciative, shumica prej tyre: kanë mohuar çështjet si atë se Isa është Zot, por e llogaritin prej të vdekurve. Prej 31 peshkopëve, 19 peshkop e llogaritin si “God supreme agent”, Gazeta DAILY NEWS, i datës 25.06.1984 të

cilën e ka raportuar libri “Anëtarët e kishës angleze dhe mendimi se Isa është Zot”

ref.: Ahmet Didad, libri “El Muhtarul Islami”, fq.23,24.

6 - Tivrati është libër i cili përbëhet prej shumë librave, ndonjëherë ndonjë libër i përshkruhet ligjit të librit të shenjtë (Tivratis) e ndonjëherë fshihet nga ajo, si f.v.: “Fletushka e Bernabës” dhe “Mendimet e Butros”, “Pastori Harnes”, “Porositë e Jakubit”, dhe nuk ka qenë stabile deri sa ka përfunduar në vitin 297, pasi që është bazuar nga tekstet e Dhjatës së vjetër (Botues: Darul Mashrik 1989).

7 - Në lidhje me këtë Kur’ani ka reaguar: **“Ne krijuam qiejt e tokën dhe gjithçka ka ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh dhe Ne nuk ndiem lodhje.”** (KAF: 38)

8 - Përkundër ekzistimit të këtij teksti në librin e shenjtë, krishterët e kritikojnë Kur’anin se pse ia ka lejuar burrit të martohet deri në katër gra, disa të tjerë mendojnë se poligamia është jociivilizuese. A nuk do të ishte kjo më mirë se dashnoret e shumta në perëndim? Nëse burri e ka gruan e sëmure, a do të ishte më e drejtë që të martohet me një tjetër, apo më mirë të ketë fëmijën tjetër jashtëmartesor.

Nuk mund ta lëmë anash atë se gruaja e humb epshin seksual para burrit. Nëse një burrë martohet me një grua dhe gruaja i arrin pesëdhjetë vite, burri nuk e ka humbur epshin, ndërsa gruaja e ka humbur. Prej arsyeve tjera është se gjatë lindjeve më së shumti vdesin fëmijët e gjinisë mashkullore se sa të asaj femërore. Sipas hulumtimeve shkencore demografike, që nga starti, numri i fëmijëve femra është më i madh se i gjinisë mashkullore, duke i shtuar kësaj edhe atë se 50% e meshkujve nuk mund të martohen në fazën kur janë të aftë për martesë, sepse mashkulli nuk mund të martohet përderisa nuk e rregullon gjendjen ekonomike, por vetëm pasi t’i plotësoj mundësitë për të shpenzuar për bashkëshorten, shtëpinë, familjen, dhe atë në bazë të klasës të cilës i takon, përderisa vajza është e gatshme për martesë që nga momenti i pubertetit.

(Pjesë nga libri “Gruaja në Islam” të autorit Abdul Vahid Vafë fq.137)

Prej arsyeve më të rëndësishme në jetën e përditshme është edhe ajo se në luftëra burrave ju kanoset rrezik më i madh.

Është me rëndësi të ceket se këtë arsye e ka përdor Martin Luter Kingu, themelues i Protestantëve, në mbrojtjen e së drejtës së Poligamisë në Dhjatën e vjetër ("LUTHER WORKS TABLE TAL", vëll. i 54, fq. 109)

Përpos kësaj, shumë herë është këshilluar për familje me pasardhës dhe atë duke parapa parimin e poligamisë, posaçërisht ku ishte për çështje të zgjidhjes politike.

Mbreti Henri i VIII kur e ka humb shpresën për të pasur trashëgimtarë, gruaja e tij ia lejon të martohet me grua tjetër ("LUTHER, A BIOGRAPHY", HALLG, 26). Po ashtu Luteri ia ka lejuar poligaminë Baronit.

Mbreti Irlandez në shek. VII është martuar me dy gra dhe i ka pasur dy robëresha.

Nuk duhet harruar se sistemi i monogamisë në Evropë nuk ka hyrë nëpërmjet krishterizmit sepse pjesa më e madhe e popujve Evropian te të cilët është përhapur krishterimi, te ta prej atyre shteteve të para (Italia dhe Greqia) e kanë ndaluar poligaminë, mirëpo shumica e popujve Evropiane e kanë lejuar poligaminë, sidomos për familjet mbretërore, e kjo para se ta pranonin krishterimin e pastaj pas hyrjes në krishterizëm, në fenë e re si p.sh.: Barmiti, mbreti i Irlandës të cilin e cekëm më parë, e pastaj mbreti Charlemon (741-814) i cili i ka pasur dy gra dhe shumë robëresha. Pastaj Mbreti Fredrik Wiliam mbreti i Borusisë dhe Filip Hesse në shek. XVI të ndikuar prej rrethanave të priftërinjve e kanë lejuar që parlamenti i një pjese perëndimore të Gjermanisë në vitin 1650 të marrin vendim që për shkak të mortalitetit të popullsisë çdo qytetar të ketë të drejtë të martohet me dy gra. ("A SHORT STORY OF MARIAGE" fq. 236. autor: EDWARD WESTERMARK)

E njëjta çështje është në Gjermani në vitin 1949 pas luftës së dytë botërore ku familjet e qytetit të Bonit i kanë kërkuar Gjermanisë që të miratojnë ligj për Poligami (Abdul Vedud esh-Shelebi në librin "Mahkemetul Tarijh", fq. 130 e transmetuar nga Muhamed Jusuf Musa në librin "Ahkamu Shahsije", fq.131, Botimi i dytë).

E vërteta është se, sa i përket Poligamisë Luteri nuk ka sjell risi. Poligaminë e ka lejuar edhe paraardhësi i tij Oloni i Karlos Orshalim (314-387). Ai ka deklaruar: "Ata të cilët martohen me dy gra, nuk i nënçmojnë ata të cilët martohen me një grua, e vërteta

është se nefsi është i çuditshëm, u lejohej edhe atyre të cilët janë të dobët që të mos bien pre e prostitucionit.” (Karlos Orshalim – “Këshillat e Gjorgjit”, fq. 58, botues dhe distributor A.T.M.E, e vitit 1982)

Pse të krishterët shkojnë aq larg për të mbrojtur monogaminë, kur dihet se krishterët bashkëkohorë të Afrikës e lejojnë poligaminë, ndërsa ata refuzojnë pa i marrë parasysh të krishterët afrikanë. Ata të cilët e lejojnë poligaminë argumentohen me atë se poligamia ekziston në Dhjatën e vjetër. Në Librin Dhjata e vjetër, Mesihu ka deklaruar: “Unë nuk kam ardhur të shkatërroj por kam ardhur të ndërtoj dhe të plotësoj.” “Mahkemetut-Tarijh”, fq.121.

Sa i përket të drejtës së femrës, duhet ditur se te arabët, foshnja femër, posa ka lindur është varrosur për së gjalli, ajo shitej e blihej si plaçkë, shkurorezimi ka qenë i përkufizuar. Edhe sot në Kashmir të Indisë praktikohet ligji ku, gruas së cilës i vdes burri duhet të vetëvritet, ose së paku të mos martohet pas vdekjes së tij. Tek Romakët e vjetër, gruaja nuk ka pasur të drejtë pronësie, as të drejtë trashëgimie, as të drejtën e dëshmisë, as të drejtën e kontratës, e as të drejtën e testamentit, çështje të cilat në tërësi janë në kundërshtim me Kur’anin.

Ne mesjetë, në vendet krishtere femra është konsideruar magjistare (shtrigë), e duke i akuzuar me këtë i kanë ekzekutuar më shumë se njëmijë gra. Pozita e gruas është përmirësuar në kohën e Renesancës, mirëpo kjo nuk ka zgjatur shumë. Edhe pas shek. XVI prapë është përqekësuar gjendja e gruas duke rënë në pozitë të ultë në shek. XVIII. “STATUS OF WOMEN”

Vlen të ceket se ligji anglez prej vitit 1805 i ka lejuar burrit ta shesë gruan e tij dhe deri në vitin 1887 nuk ia ka lejuar femrës të drejtën pronësore.

Sa i përket Islamit, Islami ia ka dhënë femrës të drejtën trashëgimore; të drejtën e pronësisë; të drejtën e dëshmisë; të drejtën e arsimimit; të drejtën e lidhjes së kontratave; të drejtën e testamentit; të drejtën e gjdhënies, etj. Në Islam, femra është e nderuar dhe e respektuar, pa marrë parasysh se a është e kurorëzuar apo është e shkurore.

9 - Tekstet kur’anore dhe hadithet e Muhamedit a.s. kanë qenë shkak i ngritjes së karakterit të luftëtarit në historinë Islame.

E kundërta ka qenë në tekstet e Tevratit të cilat i cekëm më lartë, e kanë ngurtësuar moralin, gjatë historisë dhe gjatë civilizimit të pasuesve të librit sa që edhe sot janë të freskëta krimet në Haremin e Ibrahimit, ku jehudët i kanë vrarë muslimanët deri sa ishin në sexhde e pastaj janë argumentuar edhe me Tevratin.

Të kthehemi pak mbrapa, të shikojmë se çka është shkruar në kohë të fundit. Në kohë të fundit është shkruar libri me titull: “Kujtime nga historia arabo-islame”. Distributor: “Shoqata ndërkombëtare e kryqit të kuq” i cili libër përshkruan traditën e edukatës së luftëtarit dhe mëshirën, gjatë luftës në trashëgiminë kulturore Islame. Libri përshkruan thënien e Ebu Bekri Siddikit, udhëheqësit të çlirimit të Sirisë: “O njerëz! Mos tradhtoni, mos përvetësoni, mos e thyeni besën, mos damkosni kufomat, mos vrisni fëmijë, foshnje, të moshuar apo gra. Mos i prisni hurmat e mos i digjni ato, mos prisni pemë të frytshme, mos thërrni bagëti të imta apo të trasha, bëjeni vetëm për të ngrenë...”

Libri bën krahasimin në mes të kësaj porosie dhe protokollit të parë të vitit 1977 të shtojcës së “Marrëveshjes së Gjenevës”, në nenin 51, 64.

Më pastaj libri bën krahasimin e vendimit të udhëheqësit abasit Muëtesim Bilahi, që të mos bëjë dallimin (të mos dëmtohen) familjet e të zënëve rob dhe nenit 83 të “Konventës së Gjenevës” në çështjen e sigurisë së qytetarit në kohë lufte.

Po ashtu libri bën krahasimin në mes të porosisë së Ali ibn Ebu Talibit: “Kur të hyni në ndonjë vend, mos sulmoni të plagosurit, mos hyni në shtëpi të tyre pa lejen e tyre, mos merrni asgjë nga pasuria e tyre, mos i maltretoni gratë edhe nëse ju ofendojnë dhe kujtoni Allahun nëse dëshironi të mëshiroheni” dhe në mes të nenit 41, 72 të protokollit 77 të “Konventës së Gjenevës” (Gazeta Ahram e datës 06- 05 -1994, Thënie nga: Ahmet Bexhet)

Nga këto veçori morale të Islamit janë edhe mbajtja e premtimit ku Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an thotë: **“Meqë keni premtuar, pra zbatoheni premtimin e dhënë ndaj All-llahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se All-llahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, All-llahu e di se çka punoni. Mos u bëni (në çështjet e betimit) si ajo (grua) që e prish tjerin e saj pasi të ketë dërdhur fort, e t’i bëni betimet tuaja dërdhi (mashtrim) mes jush, për shkak se një popull është më i madh se tjetri. All-llahu vetëm ju sprovon me këtë, e në ditën e**

gjykimit Ai gjithsesi do t'ju sqarojë atë gjë rreth të cilës kundërshtoheshit.” (en-Nahl: 91, 92). Ajeti i urdhëron muslimanët që t'i zbatojnë premtimet e tyre edhe nëse është në dëm të shtetit të tyre, saqë muslimanët të cilët jetojnë jashtë shtetit Islam nuk kanë të drejtë që shteti Islam t'i shfrytëzojë kundër armiqve të tyre nëse kanë marrëveshje në mes tyre: **“E nëse ata kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të obliguar t'u ndihmoni, përveç nëse është puna kundër një populli që me të keni marrëveshje (nuk mund t'u ndihmoni në luftë kundër atij populli). All-llahu mbikëqyr atë që veproni”.** (Enfal: 72)

Kjo nuk ka qenë vetëm në teori por edukatë shoqërore. Hudhejfete bin el-Jemame në një rast ka thënë: “Ajo çka më ka penguar që të jem pjesë e luftës së Bedrit është se kam dalë unë dhe Ebu Husejli dhe jemi zënë rob nga pabesimtarët Kurejsh. Ata thanë: Ju e dëshironi Muhamedin. Ne u thamë: Nuk e dëshirojmë Muhamedin, por dëshirojmë të shkojmë në Medine. Pastaj ata morën besatimin prej Allahut dhe sigurinë se do të shkojmë në Medine dhe të mos i luftojmë ata. Pastaj shkua te i dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe e lajmëruam për këtë rast, Muhamedi a.s. tha: Shkoni. Pastaj e ndërpreu garancinë dhe sigurinë dhe na tha që t'i mbështetemi Allahut dhe të ruhem i prej tyre.

Prej rasteve tjera është qëndrimi i pejgamberit a.s. me Ebi Xhendel bin Suhejlin bin Amrin i cili ka shkua te Jusufi. Ebi Xhendel bin Suhejlin bin Amri kishte ikur nga pabesimtarët e Mekës e që në atë kohë duhej zbatuar marrëveshja e Hudejbijes e që në një pikë të marrëveshjes kishte qenë se: Nëse një nga muslimanët nga Kurejshitët shkon nga Meka në Medine Pejgamberi s.a.v.s duhej t'ua kthente pabesimtarëve, edhe pse ibn Xhendel kishte kërkuar mbrojtje, Muhamedi a.s. u kishte thënë: “O ju musliman, unë po e kthej te idhujtarët që të mos sprovohem në fenë time.”

Islami shkon edhe më lart se kaq sa që arrin në nivelet e larta të bujarisë dhe fisnikërisë. Nuk lejon mashtrimin edhe pse ndien intencat e mashtrimit të të tjerëve por del haptazi: **“Nëse ti e sheh tradhtinë e një populli (ndaj marrëveshjes), atëherë edhe ti ua kthe atyre (marrëveshjen) në mënyrë të njëjtë, sepse All-llahu nuk i do ata që tradhtojnë (fshehurazi).”** (el-Enfal: 58)

Sa i përket veprimeve morale të të krishterëve përgjatë historisë, ka raste të shumta sidomos kur filluan të forcoheshin, ndërsa feja

Islame prej momentit të triumfit në kohën e Fatimijëve ishin tepër tolerant me pasuesit e librit aq sa nuk njih historia një tolerancë të tillë mes vete madje edhe në kohën kur është zhvilluar lufta e kryqëzatave (Të krishterët dhe Jehudët gjatë historisë Islame arabo-turke” autor : Filip Feraxh, Jusuf Kurba Fransijan fq, 66. “Kujt në Mesxhidi Aksa u mbuluan deri në gjunjë, bile edhe deri në fytyrë nga vrasjet të cilat ndodhën në fazën e parë të okupimit të Kudsit.” Sipas burimeve Evropiane janë vrarë me dhjetëra mijëra muslimanë, numri i muslimanëve të vrarë ka arritur shifrën në 100 000 të vrarë. Pas kësaj mbreti i ekspeditës së kryqëzatave Mbreti Anglez Riçard ka vrarë 2000 deri 3000 musliman të zënë robër dhe pas masakrimit i kanë djegur trupat e tyre.

Salahudin Ejubi e ka rikthyer qeverisjen e muslimanëve, ashtu që i ka liruar të varfrit e krishterë pa kurrfarë kompensimi, pas kësaj ka urdhëruar që pasuria të shpërndahet në mënyrë të barabartë në mes të të varfërve musliman dhe të të varfërve të krishterë dhe të të varfërve jehud. (Ref. libri: “Perëndimi dhe bota” vëll. i I, fq.197-201 Botues “Alemul mearif”.

Bazën e qëndrimit të Salahuhidin Ejubit e kemi në Kur’an: **“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim.”** (el-Insan: 8-9)

Që do të thotë se Kur’ani i jep prioritet robërve ndaj vetvetes në çështje të ushqimit edhe nëse është fjala për atë i cili ditë më parë ka qenë i etur për të vrarë.

Shembuj të kësaj edukate gjejmë në kohën e Islamit në Andaluzi dhe Sicili ku muslimanëve ua kanë plaçkitur pasurinë, i kanë vrarë kolektivisht dhe i kanë detyruar të krishterizohen ose të migrojnë, nuk ua kanë lejuar përdorimin e gjuhës ose ua kanë ndryshuar emrat ose e kanë ndërruar çdo gjë e cila ka pas bazë arabe ose i kanë shndërruar xhamitë në kisha. Por është interesante se në të njëjtën kohë kur muslimanët ballafaqoheshin me këto çështje, në hapësirat Islame ku jetonin minoritetet krishtere nuk i kanë përjetuar këto çështje në shtetet Islame për të qenë si alibi apo për t’u hakmarrë përpos të ndonjë rasti të izoluar personal sepse në përgjithësi muslimanët janë dalluar me edukatë.

Përjashtim i vetëm në historinë Islame është masakra në Turqi ndaj Armenëve gjatë viteve 1914-1924 nga shteti Turk gjatë luftës së

parë botërore, mirëpo këtu duhet pasur parasysh se kjo ka ndodhur gjatë qeverisjes laiciste Turke. Turqia e cila ishte e çrregulluar gjatë sistemit kemalist atëherë kur Islami ishte larguar nga qeverisja Kemaliste, i cili e ka larguar Islamin politikisht dhe në kohën kur kanë ndodhur ato ngjarje gjatë viteve 1915 kanë ndodhur nga ateistët dhe hebrenjtë, kjo gjë konfirmohet nga libri për historinë arabo-turke të Galib Ferrixhit dhe Jusuf Kerbaqit e cila është përkthyer nga gjuha franceze fq. 65, 202 dhe 229.

Ndonjë X person mund të paragjykojë për sjelljen e luftëtarëve dhe të kalorësve (të kryqëzatave), mirëpo parashtrohet pyetja:

Pse të ketë luftë?

Pse Islami ndërlidhet me luftëra?

“Në Islam luftërat nuk detyrohen, mendohet se luftërat zhvillohen vetëm për pasuri dhe për materializëm, shkaqe të cilat shkaktojnë luftën e cila merr jetë të shumta. Luftërat islame nuk kanë qenë luftëra të cilat kanë pasur për qëllim nënshtrimin e popujve, ashtu siç mendohet në kohën bashkëkohore ku pastaj banorët e atyre vendeve të okupuara duhet të mbesin të shurdhër, memec dhe të verbër. Nuk kanë qenë luftëra të cilat i zhvillon perëndimi kundër njerëzimit vetëm për të realizuar përfitime materiale.” (“Es-selamul-Alemije vel Islam” Prof. Sejjid Kutbi fq.189-192)

“Në të vërtetë, në Islam lufta zhvillohet për të mënjeluar krimin i cili shkaktohet në mes të njerëzve dhe dëgjimit të ftesës, ose nëse sprovohen me fenë e tyre, në të cilën e zgjedhin pasi që pajtohen me Islamin, siç ishte rasti për ndërprerjen e padrejtësisë së atyre të cilët pretendonin se e kanë të drejtën e Zotit në tokë dhe uzurponin toka dhe kërkonin të adhurohej tjetër pos Allahut.” (Ibid, fq. 34)

Kështu pra, Islami nuk përkujdeset vetëm për paqen kombëtare por edhe atë ndërkombëtare. Nuk rri heshtur dhe të përfitojë paqe me një shtet nëse brenda atij shteti, me fjalë tjera qytetarëve të atij shteti u bëhet padrejtësi. Në esencë feja islame gjithmonë është për luftë mbrojtëse me fjalë tjera lufton kur është në pyetje mbrojtja. Është urdhër në Kur’an **“Dhe luftoni në rrugën e All-llahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën)”**. (el-Bekare, 190)

Po ashtu ajetin tjetër

“Ata do t’u luftojnë juve vazhdimisht për t’ju zmbarsur nga feja juaj nëse munden...” (el-Bekare, 217)

Këtë e dëshmon historia, këtë e shohim edhe sot.

Argument për këtë shohim në Bosnje, Kashmirë dhe tentimet për të ndërhyrë ushtarakisht edhe në Algjeri.

Para Muhamedit a.s. kanë luftuar pejgamberët si f.v: Siç përmendet në Tevrat, edhe pse ndryshon çështja se Musa a.s. ka urdhëruar vrasjen e grave të zëna rob lufte dhe po ashtu fëmijët siç kemi treguar më herët (pasi që kjo nuk është e vërtetë).

Po ashtu edhe Isa a.s. sipas tekstit të Inxhilit kur e ka kuptuar për komplotin e Jehudëve ka urdhëruar që të blihen shpata deri sa janë detyruar t'i shesin rrobat për të blerë armë (shpata).

Islami asnjëherë nuk ka luftuar për t'i detyruar të tjerët për të pranuar fenë Islame sepse ekziston rregulli kur'anor: **“Nuk ka dhunë në fe.”** (el-Bekare, 66). Kështu ka qenë në historinë tonë. Këtë e kemi argumentuar nga Sir Arnold në librin e tij “Daëvetul Islam” E transmetuar nga IBID fq.34 saqë në fq. 51 thuhet: “Nga këta shembuj të cilët i kemi paraqitur për tolerancë Islame të cilën e kanë pasur muslimanët të cilët i kanë dominuar mbi arabët e krishterë në shek. e parë të hixhretit e cila ka vazhduar në shekujt në vijim, mund të konstatojmë se ato fise krishtere të cilat e kanë pranuar fenë Islame ata e kanë pranuar me vullnet të lirë dhe se arabët e krishterë të cilët jetojnë sot në shoqërinë muslimane e vërtetojnë këtë tolerancë.

Në tërësi e kundërta ka ndodhë me të krishterët të cilët kanë dominuar ndaj muslimanëve në Spanjë pas rënies së Kordovës ku muslimanët janë detyruar të kthehen në krishterizëm, posaçërisht pas ardhjes së mbretit Çarls në vitin 1512 ku thuhej se: ekzekutohet me vdekje, ose robërohet me robërim të përjetshëm pastaj ose i konfiskohet pasuria dhe dëbohet nga Spanja ai i cili nuk i nënshtrohet këtij urdhri. Pastaj është marrë fushatë në shndërrimin e xhamive në kisha. Është interesant se te muslimanët edhe pas konvertimit në Krishterizëm janë shtypur.

Nuk kanë qenë vetëm këto çështje të të krishterët, por Kardinali spanjoll i asaj kohe ka urdhëruar tubimin e të gjitha librave arabe dhe pas tubimit i kanë djegur (pjesë nga libri: “Muslimanët e mundur” autor: Abdulah Xhemaludinë i cili mbështetet në referenca nga gj. spanjolle, franceze dhe angleze).

Ky reagim i Spanjës ka qenë reagim i kundërt i tolerancës Islame sa që në kohën e qeverisjes Islame kanë pasur të drejtë dha kanë pasur mundësi për të organizuar edhe konferenca si f.v.:

- Konferenca Eshlibije e vitit 782.

- Konferenca krishtere e Kordovës e vitit 852.

Marrëveshja e të krishterëve në kohën e qeverisjes Islame konsiderohet prej argumenteve se janë respektuar bindjet fetare të popujve të cilët kanë jetuar në qeverisjen islame edhe pse kuptohet që toleranca Islame ka ndikuar që shumë të krishterë të përqafonin islamin dhe nuk janë arabizuar por ata (të krishterët) dhe hebrenjtë me të drejta të barabarta kanë arritur në poste të larta shtetërore.

Spanja Islame ka qenë shteti i vetëm Evropian në të cilin hebrenjtë kanë qenë të mbrojtur dhe të siguruar nga shteti ("Hadaretul Arab", autor: Gustav Lebon, përkthyes: Adil Zeatir, fq. 276-277)

Feja Islame nuk është fe e dhunës dhe e luftës por është fe e paqes dhe e mëshirës. Në hadithë shohim se një grua ka hyrë në zjarr nga shkak se e ka mbyllur një mace dhe as nuk e ka ushqyer dhe nuk e ka lejuar të ushqehet me bimët në tokë, në anën tjetër i janë falur mëkatet mëkatarit i cili i ka dhënë ujë qenit të etur.

Në Kur'an lexojmë:

"Andaj, (të keqen) ktheje me mirësi, se atëherë ai, mes teje dhe të cilit ka armiqësi, do të bëhet (si) mik i afërt." (Fussilet: 34)

"E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: Paqe!" (El-Furkan: 63)

"...dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit." (Ali Imran: 134)

10 - "Bible myths: Their Parallels in other religion"

Është transmetuar nga libri "Besimi idhujtar në krishterizëm",

autor: Muhamed ibn Dhahiri el bejrutiji

Botues: Darus sahveti

Kur'ani ka tërhequr vërejtjen në mosadhurimin e idhujve.

"Thuaju: O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë të vërtetës dhe mos shkoni pas epsheve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që u kanë shkaktuar të tjerëve humbje dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë." (el-Maide: 77)

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"E jehuditë thanë: Uzejri është djali i All-llahut, e të krishterët thanë: Mesihu është djalë i All-llahut. Ato ishin thënie të tyre

me gojë e tyre (faza të thata), që imitojnë thëniet e jobesimtarëve të mëhershëm. All-llahu i vraftë, si largohen (nga e vërteta)!” (et-Tevbe, 30)

11 - “The christians need not to be troubled by Quranic prophecy of this sort. Own daily news papers constantly forecasts political events of this kind.”, faqe. 85.

12 - Reuf Ebu Seade “Min iëxhazil Kur’an fi eaxhamil Kur’an”, vëll. i II, fq. 283;

Reuf Ebu Seade “Min iëxhazil Kur’an fi eaxhamil Kur’an”, vëll. i II I, fq. 277;

Reuf Ebu Seade “Min iëxhazil Kur’an fi eaxhamil Kur’an”, vëll. i II fq. 285.

13 - Në librin e shenjtë (Bibël) “Mezamijr” 84 : 5-7 lexojmë: “Lum për popullin të cilëve u vjen ushqimi duke shkuar rrugës për në shtëpinë e shenjtë dhe duke kaluar nëpër bregore të thata çelin burime të ujit dhe shiu pranveror u sjellë begati të shumta.”

“Bregun e thatë – Beke” e lexojmë edhe në gjuhën angleze “The valley of Baca” që në përkthim do të thotë “Bregu Beke”, ndërsa “Beke” është emër prej emrave të qytetit të Mekës sepse emrat e qyteteve nuk përkthehen. Po ashtu në Palestinë nuk gjendet ndonjë vend prej vendeve i cili quhet Beke, pra që quhet Meke (“Young concordance” fjalor anglisht-anglisht).

Këtë e forcon edhe King James i cili në vend se të përdorë fjalën “Burimet e ujit” e përdor fjalën “Burim i ujit” e cila fjalë është më e përafërt me termin islam, pasi që në bregun Beke është burimi i ujit zem-zem.

Kështu pra, teksti në libër është përmendur: el-Haxh, shtëpia e Allahut – burimi i ujit në kodrinën Beke (e cila nuk është në Palestinë). A nuk tregon kjo për Qaben në Meke? Njësoj gjenden sinjale tjera për Qaben në “Sufur el Mezamirë” : 60.

Kjo është ajo ku përmendet Qabja në librat kanunore të cilat jehudët dhe të krishterët i kanë bazë të adhurimit, përderisa në librat tjera të cilat nuk i kanë bazë të adhurimit përmendet në forma tjera.

Në librin “Ademi dhe Hava” (nga librat Esrarë) lexojmë se “Allahu është Zotëria i garantimit të vendeve në të cilat ndërtohen shtëpitë e Tij” (7, 5, 23).

Kjo bie në harmoni me thënien e Zotit të Lartmadhëruar në Kur’an: “Përkujtoje kur Ne e udhëzuam Ibrahimin për në vendin e shtëpisë (Qabës): të mos më përshkruaj Mua shok, pastroje shtëpinë Time për ata që e vizitojnë (bëjnë tavaf) që qëndrojnë në këmbë duke u falur, përkulur dhe që bëjnë sexhde.” (El-Haxh: 26)

Në librin “Babilat” fq. 22, 24, lexojmë thënien e Ibrahim Halilit: “Këtë shtëpi e kam ndërtuar për veten time, që të vendos emrin tim në tokë dhe do të quhet “Shtëpia e Ibrahimit”

Kështu e ka përshkruar dijetari Xhonberg në librin “The legend of the jews” duke e gjurmuar nga burimet Jehude të vjetra se deri sa Ibrahim debatonte me Nemrudin e ka paraqitur veten se është rojtar i shtëpisë së Allahut.

14 - Përmendet në ëndrrat e Palit në libra se Pali ka parë në ëndërr se është ngritur (në Miraxh) në qiell në qytetin e Mesihut dhe në atë ëndërr ka parë një lum të bardhë si qumështi, emri i të cilit është “Ekberusa”. Kjo tregon qartë se ky emër është i përafërt me fjalën “Kevther” posaçërisht kur dihet se fjala “Ekberusa” është përmend edhe në gjuhën aberije në librin “Ademi dhe Hava” sa që është përmendur se kur ka vdekur Ademi a.s. është larë nga ky ujë. Dihet se gjuha aberije është e përafërt me gjuhën arabe.

Është interesant fakti se specifika e ngjyrës së lumit (më e bardhë se qumështi) haset edhe në hadithin sahihë (Transmetues Ahmedi dhe Muslimi nga Thubani dhe e ka saktësuar Albani). Po ashtu e hasim pastrimin e Ademit në hadithin të cilin e transmeton Hakimi nga i ati i tij dhe e ka saktësuar Albani.

Sa i përket Palit për ëndrrën e tij se Ekberusa në qytetin e Mesihut është argument shtesë për paralajmërimin se jehudët pejgamberin e kohës së fundit e kanë quajtur “Mesihu i pritur”. Sipas mendimit të Palit rezultoi se Isa është pejgamberi i kohës së fundit që nënkupton se Ekberusa është pejgamberi i fundit ashtu siç thuhet në islam.

15 - Lexojmë se në disa shkrimet të zbuluar nga mesi i shek. XX në “Detin e vdekur” se shenjat në trup të pejgamberit të kohës së fundit i përngajnë HAJJATI ADES. Po kështu është edhe në librin

“HAJJATI SEPPER ASEP” këto shenja të trupit janë të ngjashme me HAJATI ADES (Shkrimet janë në: “The old Testament pseudobiography”, fq. 250, Shnemelcher)

Kjo përputhet me biografinë e Muhamedit a.s. dhe të haditheve fisnike të transmetuara nga Ahmedi, Taberaniju, nga Ibn Abasi, Muslimi, Tirmidhiju, Nesaiju nga Abdullah bin Sarxhes.

16 - Përmendet në “Enciklopedinë jehude” në kapitullin ABRAHAM se termi muslimanë është për ata të cilët e nderojnë dhe i dorëzohen vetëm Allahut, në librin “Tekvijn”, fq. 1-17, ku Zoti i Lartmadhëruar e ka urdhëruar Ibrahimin që t’i dorëzohet Allahut (MUKEREMEN LEH = BECOME SHELIM)

Kjo përputhet me atë të cilën e tregon Kur’ani për Ibrahimin: **“Zoti i Tij i tha dorëzohu. Ai (Ibrahimi) tha: - I dorëzohem Zotit të gjithë botëve.”** (El-Bekare: 121)

17 - Përmendet në librin “Ruëje Ibrahim”, libër i cili është shkruar në shek. e II ndërsa nuk është gjetur deri në shek. XIV (që do të thotë se ka qenë i panjohur për më shumë se dhjetë shekuj) se pejgamberi i kohës së fundit do të lind në shek. e XII nga pasardhësit e Babilonisë. Dihet se kjo ka ndodhë në shek. e VI para erës sonë (ref. “Kiëtabul Kuds”, Darul Mashrik, 1989). Kështu pra, pejgamberi i kohës së fundit do të lind në shek. VI të erës sonë. Në këtë shekull ka lindur Muhamedi a.s. siç përmendet në Talmudë (Senhedirna, 97).

Po ashtu është përmendur në librin “Epoka e Musait” ku thuhet se pejgamberi i kohës së fundit do të paraqitet 25 “USB” pas vdekjes së Musait, ndërsa në librat jehude “USB” ka kuptimin e shtatë viteve (1 USB = 7vite). (ref. “The apocropha”, 8, “pseudi pigrapha of the testament”, fq. 423, Charles).

Kështu pra paraqitet pejgamberi i pritur (i paralajmëruar) pas vdekjes së Musait a.s.

250 X 7 = 1750 vite

Këtë e ka përmendur “Darul Mearif Jehudije”.

E ka përmendur “Kitabul Mukades”, botues “Darul Dimashk”.

Firauni i Musaut (te ta konsiderohet Remsisi i dytë) ka vdekur në vitin 1223 para erës sonë, ashtu që patjetër se Musai a.s. ka vdekur 40 më vonë 1223-40 p.e.s. faktikisht 1183 p.e.s.

Kështu do të lind peygamberi i pritur. $1183 - 1750 = 567$ sipas e.s. nëse i llogaritim (i zbresim 250 USBU)

- Nëse llogaritet lindja në 250 USBU ose me fjal tjera $-1183+1750$ vite = 573

- Nëse llogaritet lindja e paralajmëruar pas 250 USBU është e barabartë me 573.

Dihet se Muhamedi a.s. ka lindur në vitin 570 të erës sonë.

18 - Teverati, peygamberin e kohës së fundit e përshkruan se do të vijë t'i luftojë armiqtë e Allahut (përderisa këtë nuk e bën Isa) dhe se ai do të vjen me shariat të ri kur ka thënë: "Mos mendoni se unë do të kundërshtoj Namusin." (Meta : 5-17) dhe se do të jetë një dritë për popuj. Kjo është në kundërshtim me atë të cilën e ka thënë Mesihu për veten e tij: "Jam i dërguar për të humburit, te shtëpia e Israilëve." (Meta : 15-25). Po ashtu çështja e peygamberit të pritur se është dritë e popujve nuk bie në harmoni me idenë e jehudëve për peygamberin e fundit dhe për atë e shohin se është çështje e përfundimtare dhe se ai nuk do të lejojë adhurimin e idhujve (Dhe kjo nuk arrihet prej Mesihut, gjithashtu) dhe se ai do të jetë nga vendet shkretinore: "Përgatitni rrugën në shkretëtirë për Zotin." (Shaëbën : 3 : 4)

Ky shembull dhe shembujt tjerë të shumtë, gjithmonë kanë ekzistuar te një pjesë e jehudëve (el-Hasanijnë).

Në një vend në shkretëtirë të Palestinës (Vadil Kamrani) duke pritur peygamberin e kohës së fundit, i cili i ngjanë Musait ("Sufur Tethnije", 15-18). Këtë e thonë shkresat e këtij grupacioni të cilën e ka përmend Ejub Shehraniju, profesor në universitetin "Ruhul Kuds" në "Xheridetu Biblije" aded Kanunul evvel 1991.

Cilësitë të cilat i kemi përmendur më herët i shohim në: "Hurb"; "Sheriaten Xhediden"; "Umen"; "Ibadetu Esnam"; "Sahraë" dhe në vende të shumta të Teveratit si në "Sufur Shuajbe" fq. 42, do t'i shohësh të gjitha këto cilësi. Të gjitha ato cilësi i përshtaten jetës së Muhamedit a.s., përderisa paralajmërimet të cilat i përngjajnë peygamberit të kohës së fundit me Musanë, për të cilat për shkak të tyre janë nxjerrë disa jehudë në shkretëtirë i shohim në "Sufur Tethnije" 18:18. "Për këtë arsye në mesin e tyre kishte peygamber prej mesit të vëllezërve të tyre ashtu si ti dhe fjalën time e vendosi te ta." Në tekst përmendet se peygamberi i pritur nga beni israilët të

pasardhësve të Ismailit, po të ishte Israili do të thoshte nga pasardhësit e tij (Israilit).

Përderisa sa i përket çështjeve ku kanë ngjashmëri Musai a.s. me Muhamedin a.s. është fakti se kanë lindur me lindje natyrale, ndërsa lindja e Isait a.s. ndryshon prej tyre.

Po ashtu Musai a.s. dhe Muhamedi a.s. janë martuar dhe kanë pasur fëmijë dhe kanë qenë edhe peygamber edhe burrështetas në të njëjtën kohë, kanë migruar kur kanë qenë të moshërritur dhe kanë luftuar me armiqtë e tyre dhe shpallja ka qenë e shkruar gjatë jetës së tyre, mësimi i tyre ka qenë shpirtëror dhe ligjor, kanë qenë të refuzuar nga popujt e tyre, pastaj janë pranuar. Në të gjitha këto cilësi kanë pika të përbashkëta, ndërsa e kundërta ka qenë me Isain a.s. i cili ka pika të përbashkëta me Jahjain a.s. dhe jo me Musain a.s. Sa i përket librave tjerë krishtere (përpos Tevratit) të cilat kanë qenë para Kur'anit, në to shohim cilësi tjera për peygamberin e kohës së fundit, saqë në librin "Ruëja Ibrahimë" nga librat "Kutubul Esrarë" shohim se ai do të nënçmohet nga idhujtarët e që më pastaj do të shpëtoj, gjë që na e përkujton një paralajmërim tjetër nga Tevrati se disa prej bijve të Ibrahimit do ta pasojnë dhe disa tjerë nuk do ta pasojnë. Kjo i ka ndodhur Muhamedit a.s. ku idhujtarët arabë e kanë nënçmuar e më pastaj e kanë pasuar, po ashtu e kanë pasuar disa pasardhës të Ibrahimit (arabët janë pasardhës të Ismailit) dhe disa jehudë prej pasardhësve të Is'hakut.

Këtë e vërteton dokumenti i Damaskut (nga dorëshkrimet e "Detit të vdekur") ku tregohet se peygamberi i fundit do të vjen me shariat të ri (po ashtu është përmendur në "Fletushkat e Shuëbes të librit të shenjtë") të cilën e refuzojnë shumica e jehudëve.

Po ashtu e përmend edhe letra e Xhejm Serije "Cilësitë e peygamberit të fundit dhe pasuesve të tij". Kjo letër i përngjanë letrës qiellore "Devletul muntedhar el-ilahije" ku thuhet se "nga një hurme del një syth e pastaj prej atij sythi rezultojnë fryte rreth saj dhe pastaj ato fryte rriten".

Ky shembull i ngjanë shembullit të cilin e ilustron Kur'ani për Muhamedin a.s. dhe për ata të cilët e pasojnë:

...dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. **"Ata janë si një farë e mbjellë ku mbin filizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet, ajo e mahnit mbjellësin."** (El-Fet'h : 29)

Posaçërisht kur dihet se trangu (pema) i cili përmendet i ngjanë besimtarëve (hurma) është i njëjti trangu (pemë) i cili përngjasohet me Muhamedin a.s. dhe besimtarët (Taberaniju nga Ibn Umeri, e ka saktësuar edhe Albani).

19 - Në fletushkat e “Danjelit” të librave të shenjtë përmendet se katër mbretëri do të rrëzohen dhe pastaj do të vjen pejgamberi i kohës së fundit. Këtë e kanë interpretuar librat e Talmudit (Abuda Zara) “Adijat el jehudije”.

Dihet se shteti islam i ka rrëzuar ato mbretëri. Kështu pra shteti islam është shteti i pejgamberit të kohës së fundit.

Këtë paralajmërim e përforcojnë edhe paralajmërimet e tjera në librin “Ez-Zind afesta – Aksaja te idhujtarët” e cila tregon zhvillimet në të ardhmen të perandorisë Persiane, me degët e pemës të përbëra me xehe të ndryshme. Pastaj përmendet se dega e fundit (Mbretëria e fundit) do t’i rrëzoj perandoritë (mbretëritë) tjera në tokë, ushtria e drejtë në kohë të fundit (Zend avesta), BYT, 1.1.5., e ushtria e cila e ka rrëzuar perandorinë persiane është ushtria e Muhamedit a.s.

20 - Kur’ani i sfidon ithtarët e librit sepse ai (Kur’ani) është i përmendur te ata: **“Ai është në fletushkat e të parëve.”** (Shuaraë : 196)

Faktikisht këtë e hasim në Tevrat në fletushkat 3, 16, 18, ku flitet për një grup të jehudëve: “E përmendin Allahun në mes tyre, Allahu i dëgjon ata dhe atyre u shkruan shkresë duke i përmendë dhe për së dyti zgjedh të mirët prej jo të mirëve.” Dihet se Kur’ani veten e titullon me termin “Përmendje” (Dhikr, Dhikra, Tedhkireten). Përderisa nëse tubohen interpretimet sa i përket “librit përkujtues” që të gjitha shpijnë te fjala e Zotit Krijues dhe se tipari i “përmendjes së librit” është për Zotin e Lartmadhëruar (“The international critical comentary”).

Atë të cilën e treguam e vërteton edhe thënia paralajmëruese: “Dhe mendojnë herën tjetër” që do të thotë se ka të bëjë me “librin e përkujtimit” çfarë e ndërlidhë këtë pretendimin të cilin e thonë të krishterët. Atë çka e treguam e mbështet edhe thënia “për të dytën herë”. Për të parën herë kanë qenë ditët e Musait a.s.:

“Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: O beni israilë, unë jam i dërguar i All-llahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para

meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed! E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: Kjo është magji e hapët.” (Es-Saf: 6)

Është e pamundur që të anashkalohet paralajmërimi për pejgamberin e kohës së fundit në Tevrat, duke përmend Ahmedin, po ashtu shkretëtira për të cilën treguam më herët, posaçërisht për tiparet e pejgamberit të pritur në “Fletushka”, “Mezamiër”, etj., p.sh., “Mezamiër” fq. 17, 45: “Do ta bëj emrin tënd që të kujtohet në të gjitha gjeneratat dhe do të lavdëroresh (ka për qëllim Mesihun e pritur) nga popujt përgjithmonë.” Kjo nënkupton se pejgamberi i pritur është i lavdëruar ndër popuj.

Po ashtu thënia e Hixhijut (7:2): “Do t’i bëj të tronditen të gjithë popujt, pastaj do të vjen përfundimi i popujve (ka për qëllim pejgamberin e pritur)”

Prifti Muhted Abdul Ehad në librin “Muhamedi në librin e shenjtë” fq. 105 e ka përmendur se bërthama e fjalës “përfundimi” i përmendur në tekstin e mëparshëm ka për qëllim “Ahmedi” në gjuhën aberije (Himada) e cila në të njëjtën kohë ka për qëllim “Ahmed-in” që nënkupton se do të vjen Ahmedi për të gjithë popujt, mirëpo përkthyesi e ka preferuar fjalën “përfundim”.

Është interesant ekzemplari i Kadisit (Vulgare) e librit të shenjtë nuk e ka paraparë formulimin e gjuhës aberije (H.M.D.).

Sa i përket thënies së Isës, për të cilën sinjalizon Kur’ani, ka ngjashmëri dhe përputhet në Inxhilin e Gjonit.

Përfshinë tre kapituj të Inxhilit (14-15) deri (11-16): “Nëse nuk më doni, mbani mend këshillat e mia, unë do të kërkoj nga i Ati që të ju jap ndihmëtar tjetër i cili do të jetë gjithmonë me ju, i cili do të ua mësoj çdo gjë. Më mirë është të shkoj te i Ati sepse nëse nuk shkoj nuk do të vjen ndihmëtari.”

Fjala “Ndihmëtari” këtu jep kuptime të shumta si f.v. mbështetës, mbrojtës, ndërmjetës, etj., baza e kësaj fjale është gjuha greke “PARIKLETOS”, shih librin e shenjtë i botuar në vitin 1989. Faktikisht disa botime e kanë lënë të shkruar fjalën “PARIKLETOS” e cila është e ngjashme me fjalën tjetër “PERAKLETOS” e cila ka kuptimin “Ahmed” siç ka qenë në botimet e hershme të vitit 1969.

Siç shihet është dallim i vogël në mes të fjalëve dhe nuk është larg mendjes se fjala “PERAKLETOS” është fjala “PARIKLETOS” e cila në

ekzemplarët e vjetër të librit të shenjtë është bërë gabim teknik nga fjala “PARIKLETOS” në “PERAKLETOS.

(“Min iëxhazil Kur’an fi eaxhemil Kur’an”, fq. 212, vëll. i II.)

21 - Pejgamberi i fundit përmendet me nofkën “Besnik” në gjuhën aberije në librin “Uhnuh” prej librave “Serd bigrafa” ndërsa dihet se Muhamedi a.s. e ka pasur nofkën “Besnik”.

